




**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



**Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës**  
*Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave*

# Buxhetimi për një mjedis më të mirë

**Analizë gjinore e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**





# **Buxhetimi për një mjedis më të mirë**

Analizë gjinore e shpenzimeve dhe shërbimeve në  
Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nga Nicole Farnsworth, Iliriana Banjska, Nerina Guri dhe Donjeta Morina  
për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2016

Autoret: Nicole Farnsworth, Iliriana Banjska, Nerina Guri, Donjeta Morina

Perkthyer nga Mars A.

Shtypur nga “NightDesign”, me materiale ekologjike

ISBN 978-9951-737-00-5

Ky publikim është mundësuar me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Opinionet e shprehura në këtë publikim janë të autoreve dhe jo domosdoshmërisht të qeverisë së SHBA-ve ose USAID-it.

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)

## Tabela e përmbajtjes

Mirënjohje.....	2
Akronimet .....	3
Përmbledhje ekzekutive.....	4
Hyrje .....	5
Pse MMPH-në? .....	6
Për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor .....	6
Buxheti i përgjithshëm .....	8
Administrata qendrore .....	12
Divizioni i Burimeve Njerëzore .....	13
Divizioni për Buxhet dhe Financa .....	13
Departamenti i Prokurimit .....	14
Divizioni për Komunikim me Publikun .....	15
Departamenti Ligjor .....	15
Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave .....	16
Divizioni për Integritet Evropian dhe Divizioni për Koordinim të Politikave .....	17
Njësia për të Drejtat e Njeriut .....	18
Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit .....	18
Divizioni për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor .....	19
Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale .....	19
Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate .....	20
Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës.....	20
Departamenti i Ujërave .....	22
Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim.....	24
Divizioni për Planifikim Hapësinor .....	27
Divizioni i Ndërtimit.....	27
Divizioni i Banimit.....	28
Departamenti i Shpronësimit .....	31
Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit .....	33
Divizioni për Inspektim të Mbrojtjes së Mjedisit, Natyrës dhe Ujërave .....	34
Divizioni për Inspektim të Ndërtimit dhe Planifikimit .....	34
Zyra e Projektit për Fshatin Hade.....	35
Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.....	36
Instituti për Mbrojtjen e Natyrës.....	37
Instituti për Hidro-meteorologji.....	37
Instituti për Planifikim Hapësinor .....	38
Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" .....	39
Drejtoria e Parkut Kombëtar të Sharrit.....	39
Drejtoria për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim Mjedisor.....	39
Agjencia Kadastrale e Kosovës.....	41
Punimet e cituara .....	44

## **Mirënjohje**

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) falënderon Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në veçanti ish ministrin Ferid Agani dhe ushtruesin e detyrës së ministrit Ferat Shala, sekretarin e përgjithshëm Arben Çitaku, zyrtarin për financa Avdullah Berisha, si dhe zyrtaren për barazi gjinore Shpresa Sheremeti për angazhimin e tyre për të punuar në institucionalizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në këtë Ministri. Të dhënat e mbledhura dhe të ofruara nga departamentet, divizionet dhe agjencitë e MMPH-së demonstrojnë angazhimin e tyre për zbatimin e Ligjit të ri për Barazi Gjinore dhe të dispozitave për mbledhjen e të dhënave sipas gjinisë, si dhe për përdorimin e këtyre të dhënave me qëllim të ofrimit të informatave për buxhetim të përgjegjshëm gjinor. Mbështetja teknike e RrGGK-së dhe koha e kaluar duke ndihmuar MMPH-në në realizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen bujare të popullit amerikan përmes projektit Partneritete për Zhvillim (Partnerships for Development - PFD) të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) implementuar nga Chemonics Internationale. Personeli i USAID PDF gjithashtu ka ofruar mbështetje të rëndësishme gjatë gjithë procesit, dhe RrGGK është mirënjohëse për këtë investim. Autoret falënderojnë Igballe Rogovën, Drejtore Ekzekutive në RrGGK, Besa Shehun, Menaxhere e Financave në RrGGK dhe Zana Rudin, Menaxhere e Projektit në RrGGK, për përkrahjen e vazhdueshme në realizimin e këtij hulumtimi. Elizabeta Murati ka ofruar ndihmë të madhe në hulumtim dhe formatim. RrGGK po ashtu falënderon Shkipe Deda-Gjurgjiali prej portofolit të Mjedisit, Klimës dhe Ripërtëritjen e Katastrofave brenda Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, e cila ka ofruar komente të vlefshme në draftin e raportit, pa pagesë.

## Akronimet

AMRK	Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion
DRPP	Drejtoria për Regjistrin e Pronave të Paluajtshme
BE	Bashkimi Evropian
ZBGj	Zyrtari për Barazi Gjinore
BPGj	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor
KRK	Kuvendi i Republikës së Kosovës,
IAEA	Standarde të BE-së dhe Ndërkombëtare
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IPA	Instrumenti për Ndihmën Para Anëtarësimit
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
MAP	Ministria e Administratës Publike
ZKK	Zyrat Kadastrale Komunale
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MeF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PFD	Projekti Partneritete për Zhvillim
PRKMB	Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
DPS	Dokumenti Planifikues Sektorial
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN-HABITAT	Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
TIT	Trajnimi i Trajnerëve

## Përmbledhje ekzekutive

Burrat dhe gratë, vajzat dhe djemtë kanë nevoja dhe prioritete të ndryshme ekonomike, sociale, arsimore dhe shëndetësore. Duke marrë parasysh rolet e ndryshme gjinore në shoqëri, politikat për mbrojtje mjedisore dhe planifikim hapësinor mund të ndikojnë te gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme. Buxheti i përgjegjshëm gjinor (BPGj) është një strategji përmes së cilës perspektiva gjinore futet në të gjithë ciklin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të buxheteve qeveritare dhe politikave të tjera fiskale. BPGj-ja përbën një detyrim ligjor për të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës, sepse mund të lehtësojë më mirë planifikimin e bazuar në performancë me qëllim që të përmbushen nevojat e kosovarëve. Kjo analizë e çështjeve gjinore synon t'i ofrojë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH-së) objektiva dhe aktivitete konkrete, nga pikëpamja gjinore, të cilat Ministria mund t'i përdorë në planifikimin e buxhetit të saj për vitin 2017 dhe për buxhetet e ardhshme, me qëllim që nevojat e burrave dhe grave të përmbushen sa më mirë.

Në këtë raport vihen në pah disa nga praktikatat më të mira që Ministria dhe departamentet e divizionet e saj mund t'i zbatojnë në pajtim me përgjegjësitë ligjore sipas Ligjit për Barazi Gjinore, për të siguruar që si gratë, ashtu edhe burrat, të përfitojnë nga puna e tyre. Këtu përfshihen:

- Sigurimin që të gjithë anëtarët e personelit të mbledhin dhe mirëmbajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë, lidhur me personat e këshilluar, të kontaktuar dhe të synuar në kuadrin e punës së tyre. Këto të dhëna mund të përdoren për të ofruar informata më të mira në procesin e planifikimit të shpenzimeve në të ardhmen, për të siguruar që nga këto shpenzime të përfitojnë gratë dhe burrat.
- Kryerjen e analizës gjinore lidhur me mënyrën se si gratë dhe burrat mund të ndikohen në mënyra të ndryshme nga një politikë e re që propozohet (p.sh. lidhur me mbeturinat industriale, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe adaptimin, ujërat, menaxhimin e mbeturinave, etj.). Shqyrtimin e përhershëm i projekt-ligjeve, politikave dhe planeve të veprimit për të siguruar një perspektivë gjinore. Kjo detyrë do të duhet të kryhet nga ana e Zyrtares për Barazi Gjinore (ZBGj) dhe nuk do të duhet të ketë kosto shtesë për Ministrinë.
- Ndërmarrjen e masave për të siguruar pjesëmarrjen e grave dhe burrave në konsultime publike lidhur me ligje, politika, dhe investime kapitale, me qëllim të adresimit të prioriteteve dhe interesave si të grave ashtu edhe të burrave. Rritjen e pjesëmarrjes së grave në konsultime publike përmes inkurajimit të komunave që të organizojnë konsultime në kohë dhe vende ku mund të marrin pjesë si gratë ashtu edhe burrat, si dhe duke siguruar që gratë të kenë njohuri për konsultime të tilla nëpërmjet bashkëpunimit me organizata lokale që udhëhiqen nga gratë.
- Shqyrtimin e materialeve të komunikimit publik nga pikëpamja gjinore me qëllim që të sigurohet që imazhi dhe mesazhet të jenë tërheqëse dhe të komunikojmë mirë si me gratë, ashtu edhe me burrat.
- Përdorimit të veprime afirmative atëherë kur hapen vende pune, me qëllim që të rekrutohen në mënyrë aktive apo të nxiten persona të kualifikuar nga gjinia e nën-përfaqësuar (zakonisht gratë), për të siguruar një përfaqësim më të baraspeshuar të grave dhe burrave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Kjo do të kontribuojë në drejtim të shpenzimeve të barabarta për gratë dhe burrat nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve. Aktualisht, gratë janë të nën-përfaqësuar, duke përbërë kështu vetëm 37.8% të punonjësve në MMPH, të cilat krijojnë 38,5% të shpenzimeve nga kategoria e shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve. Gratë mbajnë vetëm 22% të pozitave vendimmarrëse, duke marrë 29% të shpenzimeve nga nivelet më të larta të pagave.
- Krijimi i një baze të thjeshtë të të dhënave dhe përdorimi i saj për të analizuar rregullisht të dhënat e kategorizuara sipas gjinisë për zyrtarët që marrin pjesë në udhëtimet zyrtare. Kjo mund të përdoret për të siguruar informata më të mira në planifikim për t'i baraspeshuar shpenzimet e ardhshme midis burrave dhe grave, duke siguruar njëkohësisht edhe përfshirjen e perspektivave të ndryshme në takimet zyrtare jashtë vendit. si pikë reference, në vitin 2015, 36,9% të personave që kanë marrë pjesë në udhëtime zyrtare ishin gra, dhe ato kanë marrë vetëm 29,1% të shumës së përgjithshme të shpenzuar për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit.

Raporti përmban rekomandime tjera specifike për disa departamente, divizione dhe agjenci.



## Hyrje

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) është një instrument i rëndësishëm që përdoret për të ulur nivelin e pabarazive gjinore. Pra, është një strategji përmes së cilës perspektiva gjinore inkorporohet në të gjithë ciklin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të buxheteve qeveritare dhe politikave të tjera fiskale. Burrat dhe gratë, vajzat dhe djemtë kanë nevoja dhe prioritetet të ndryshme ekonomike, sociale, arsimore dhe shëndetësore. Shteti dhe organizatat buxhetore të tij duhet të sigurojnë që: 1) si gratë, ashtu edhe burrat të përfitojnë nga shpenzimet dhe shërbimet, dhe 2) t'i identifikojnë dhe adresojnë nevojat dhe prioritetet specifike dhe potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave në punën e tyre.

Që nga viti 2015, BPGJ-ja është një detyrim ligjor për të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës.<sup>1</sup> Ligji për Barazi Gjinore e përkufizon BPGJ-në si:

[Z]batimin e integritimit gjinor në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga pikëpamja e gjinisë, në rastin kur çështja gjinore është marrë parasysh në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, të hyrave dhe shpenzimeve të ristrukturimit me qëllim të promovimit të barazisë së femrave dhe meshkujve.<sup>2</sup>

Ministria e Financave gjithashtu ka inkurajuar organizatat buxhetore të përdorin BPGJ-në në dokumentet e tyre buxhetore dhe në proceset e planifikimit të buxhetit që nga viti 2014. Ky inkurajim është fuqizuar gjatë vitit 2016 dhe 2017. Ministria e Financave ka ofruar tabela të cilat të gjitha ministritë duhet t'i plotësojnë si pjesë e buxhetit të tyre për vitin 2017.<sup>3</sup>

Së bashku me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është ministria e tretë të cilën Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) e ka mbështetur në institucionalizimin e BPGJ-së. Kjo përfshin mbështetjen e Ministrisë në kryerjen e kësaj analize gjinore me qëllim të ofrimit të informatave për buxhetin e vitit 2017. RrGGK-ja ka ofruar mbështetje teknike për MTI-në dhe MMPH-në duke iu falënderuar mbështetjes financiare nga Projekti për Partneritetet për Zhvillim i USAID-it.

Ky raport përmbledhë të gjeturat e analizës gjinore të kryer në MMPH, duke u fokusuar në departamentet dhe divizionet të cilat kanë ofruar të dhëna të mjaftueshme për një analizë të tillë.<sup>4</sup> Normalisht, të gjitha shifrat janë rrumbullakosur në shifrën më të afërt në euro për qëllime të prezantimit. Shqyrtimi i tendencave të mëhershme në shpenzime mund të jetë i rëndësishëm për identifikimin e pabarazive potenciale, të cilat mund të adresohen përmes planifikimit të duhur për shpenzimet e ardhshme. Prandaj, çdo pjesë e këtij raporti shqyrton buxhetet e propozuara dhe të shpenzuara nga vitet paraprake me qëllim që të jep informata për projeksionet për vitin 2017 dhe më tej. Pastaj, secila pjesë përmbillet me rekomandimet për objektivat dhe aktivitetet të cilat departamenti ose agjencia mund të synojë t'i arrijë, e të cilat mund të pasqyrohen në buxhetin e tyre të vitit 2017 dhe në planifikimin programatik.

---

<sup>1</sup> Ligji për Barazi Gjinore, neni 5.1.5 parasheh që institucionet publike janë të detyruara të përfshijnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në "të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve".

<sup>2</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore, nr. 05/L-020, 2015, marrë nga: <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/165dc3a6-5295-4d24-8437-a50f8ed4e237/LIGJI-NR--05-L-020-PER-BARAZI-GJINORE.aspx>, Neni 3.1.17.

<sup>3</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Qarkorja Buxhetore 2017/01, marrë nga: <https://kk.rks-gov.net/kline/getattachment/26277141-8e00-4daa-90a6-9880a7f8a0f3/Qarkorja-Buxhetore-2017.aspx>.

<sup>4</sup> Ju lutemi keni parasysh që në tabelat të cilat kanë të bëjnë me buxhetet e departamenteve, divizioneve dhe agjencive të ndryshme, kolonat të cilat kanë të bëjnë me kategoritë ekonomike, për të cilat ai organ i caktuar nuk ka buxhet, nuk janë përfshirë në tabelat e paraqitura në këtë raport.

## Pse MMPH-në?

Së bashku me MTI-në, MMPH-ja është Ministria e katërt që kryen një analizë gjinore dhe që punon në drejtim të institucionalizimit të BPGj-së me përkrahjen e RrGGK-së. MMPH-ja u përzgjedh për t'u përkrahur për shumë arsye. E para dhe më e rëndësishmja, politikat e brendshme dhe të jashtme të MMPH-së prekin jetët e shumë grave, burrave, vajzave dhe djemve që vijnë nga mjediset e ndryshme. Vetëm duke analizuar se si mund të ndikojnë politikat për rregullimin e planifikimit hapësinor dhe të mjedisit të gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme, MMPH-ja mund të hartojë politika të cilat i plotësojnë më mirë nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave.

Arsyeja e dytë për kryerjen e analizës gjinore në MMPH është fakti se si vend pas konfliktit, Kosova përballet me disa çështje specifike që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe mjedisin. Pas luftës, Kosova është ballafaquar me urbanizim të shpejtë për shkak të migrimit të brendshëm nga zonat rurale në ato urbane. Kjo ka kontribuar në zgjerim të pakontrolluar të qyteteve,<sup>5</sup> e që ka rezultuar në shfrytëzim më të vogël të tokës bujqësore, infrastrukturë të dobët, shërbime të kufizuara sociale, dhe në sfida mjedisore.<sup>6</sup> Për shembull, Kosova është në rrezik të vërshimeve të shpeshta, reshjeve të mëdha të borës, thatësira, si dhe rreziqeve tjera meteorologjike.<sup>7</sup> Po ashtu, Kosova përballet me thatësira të paparashikueshme meteorologjike dhe hidrologjike, të cilat prekin prodhimin bujqësor në rajonet pa sistem të ujitjes. Mungesa e ujit i prekë kryesisht zonat e ulëta të vendit.<sup>8</sup>

Çështjet mjedisore ndikojnë në mirëqenien e grave dhe burrave. Nuk mund të jetë neutrale ndaj gjinisë, asnjë politikë apo projekt që ka të bëjë me njerëzit. Politikat ose projektet "neutrale ndaj gjinisë" supozojnë që gratë dhe burrat kanë prioritete, nevoja, pritshmëri, dhe mundësi të njëjta. Politikat dhe projektet neutrale ndaj gjinisë bartin rrezikun e fuqizimit të diskriminimit ekzistues të bazuar në gjini, ose thjeshtë iu përgjigjen prioriteteve të burrave, veçanërisht në shoqëri sikurse Kosova ku vendimmarrja aprovet kryesisht nga burrat. Në mënyrë që të krijohen politika ose të zbatohen projekte për menaxhim mjedisor të cilat janë të ndjeshme nga aspekti gjinor, çështjet e tilla si ajo se a merren parasysh përvojat e grave dhe të burrave kur është fjala për mënyrat e ndryshme të përdorimit dhe menaxhimit të burimeve natyrore merren në konsideratë. Ose a përshtaten strategjitë e reagimit, lidhur me rreziqet siç janë kimikatet toksike, me ndikimet e ndryshme që mund të kenë te gratë dhe burrat?

Në mënyrë të ngjashme, në një situatë ideale, planifikimi hapësinor duhet të sigurojë një mjedis të sigurtë dhe të qëndrueshëm për të gjithë. Kjo duhet të përfshijë mirëkuptimin dhe reagimin lidhur me atë se si njerëzit e ndryshëm i përdorin, dhe si ndjehen në hapësirat publike.<sup>9</sup> Shteti mund t'i zvogëlojë pabarazitë potenciale duke vënë në funksion politika për planifikim hapësinor të cilat i njohin dallimet dhe ngjashmëritë midis grave dhe burrave, sipas roleve dhe nevojave të ndryshme të tyre në shoqëri.

## Për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MMPH është përgjegjëse për projektimin, mbështetjen, si dhe monitorimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtje mjedisore. Midis tjerash, në përgjegjësitë dhe kompetencat e saj bëjnë pjesë:

- Të marrë pjesë në hartimin e dokumenteve strategjike për mbrojtje mjedisore dhe të vendosë norma dhe standarde në këtë fushë, në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare.

<sup>5</sup> Ec ma Ndryshe dhe Pro-Planning, *Sfidat e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor në komuna; roli i shoqërisë civile në adresimin e tyre*, Prishtina: 2016, f. 5, marrë nga:

[http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/160530170335\\_EC\\_PRO\\_Analiza\\_SHQ.pdf](http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/160530170335_EC_PRO_Analiza_SHQ.pdf).

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), *Iniciativa për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë në Kosovë*, 2016, f. 4, marrë nga:

<http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/KDRR/2013.05.28%20KDRR%20Prodoc%20SIGNED.pdf>.

<sup>8</sup> Po aty, fq. 5.

<sup>9</sup> Oxfam, *Gjinia dhe Planifikimi Hapësinor: RTPI praktikat e mira, shënimi 7*, Londër: 2007, f. 4.

- Të inkurajojë pjesëmarrjen e komunitetit në aktivitete për mbrojtje mjedisore, të zhvillojë fushata dhe projekte të tjera reklamimi me qëllim të ngritjes së vetëdijes së publikut dhe të rritjes së konformitetit me standardet për mbrojtje mjedisore dhe gjithashtu të mbështesë ngritjen e edukimit mjedisor me qëllim të avancimit të njohurive dhe ekspertizës përkritazi me mbrojtjen mjedisore;
- Të mbikëqyrë dhe vlerësojë gjendjen e mjedisit, veçanërisht efektin e veprimtarive industriale dhe ekonomike, dhe të shërbimeve publike, pasi që këto janë të lidhura me mbrojtjen mjedisore; të zhvillojë politika lidhur me menaxhimin e burimeve ujore; dhe të mbështesë zhvillimin, zbatimin dhe transferimin e teknologjive ekologjike;
- Të sigurojë përfshirjen e planit hapësinor mbarështetëror në politikën dhe programet qeveritare dhe të mbikëqyrë zbatimin e tyre përmes autoriteteve përkatëse dhe të hartojë ligje në fushën e mbrojtjes mjedisore.<sup>10</sup>

MMPH-ja, me qëllim të zbatimit të përgjegjësive të saj, ka krijuar objektiva strategjike dhe një Plan Veprimi për Biodiversitetin, i cili ka këtë objektiva strategjike:

- **Objektiva strategjike 1:** Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale sipas standardeve të BE-së dhe zbatimi efektiv i saj.
- **Objektiva strategjike 2:** Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së llojeve të bimëve dhe shtazëve, vendbanimeve natyrore dhe peizazheve reprezentative në baraspeshë natyrore.
- **Objektiva strategjike 3:** Sigurimi i mbrojtjes së integruar të natyrës përmes bashkëpunimit me sektorët tjerë, shfrytëzimi i qëndrueshme i biodiversitetit dhe ndarja e barabartë e përfitimeve.
- **Objektiva strategjike 4:** Promovimi i edukimit dhe komunikimit efektiv për biodiversitetin.<sup>11</sup>

MMPH-ja gjithashtu ka krijuar një Plan të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave, i cili ka tri objektiva kryesore të cilat korrespondojnë me këto tri parime:

- një program dhe mbështetje e veprimeve për të forcuar sistemin e menaxhimit të mbeturinave
- një program i investimeve në pjesët me probleme kritike për mbeturina, dhe
- veprime për përmirësimin e informimit dhe ndërgjegjësimin e publikut lidhur me menaxhimin e mbeturinave.<sup>12</sup>

Kur janë hartuar këto objektiva, nuk është bërë asnjë analizë gjinore për të vlerësuar shkallën se sa mund t'i prekin këto çështje dhe veprime të planifikuara gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme. Analizat gjinore mund të ndihmojnë në identifikimin e nevojave potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave, si dhe për atë se si të adresohen ato nevoja përkritazi me mbrojtjen mjedisore, biodiversitetin, dhe menaxhimin e mbeturinave. Analizat e tilla gjithashtu mund të ofrojnë informata për mënyrat se si mund të përfshihen më mirë gratë dhe burrat në përpjekjet për mbrojtje mjedisore në Kosovë.

MMPH gjithashtu e ka një Strategji Kornizë për Ndryshimet Klimatike për Kosovën, ku thuhet se gratë mund të kenë nevoja potencialisht unike që lidhen me ndryshimet klimatike që duhet të adresohen.<sup>13</sup>

<sup>10</sup> Qeveria e Kosovës, Rregullorja për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, 2011, marrë nga: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja\\_02-2011-e\\_miraturar nga\\_Qeveria-finale.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja_02-2011-e_miraturar nga_Qeveria-finale.pdf), Appendix I3.

<sup>11</sup> MMPH, *Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020*, Prishtinë, f. 12, marrë nga: [http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Strategy\\_and\\_Action\\_Plan\\_for\\_Biodiversity\\_2011-2020.pdf](http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Strategy_and_Action_Plan_for_Biodiversity_2011-2020.pdf).

<sup>12</sup> MMPH, Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2017, Prishtinë: 2013, f. 7, marrë nga: [http://mmp-h-rks.org/repository/docs/Planne\\_of\\_Republic\\_Kosova\\_for\\_WM\\_2013-2017\\_-Eng\\_644818.pdf](http://mmp-h-rks.org/repository/docs/Planne_of_Republic_Kosova_for_WM_2013-2017_-Eng_644818.pdf).

<sup>13</sup> Rishikimi i tërë Strategjisë nga perspektiva gjinore ishte jashtë fokusit të kësaj analize. Informata të mëtuqeshme janë në dispozicion në: Republika e Kosovës, Qeveria, MMPH, "Strategjia Kornizë për Ndryshimet Klimatike për Kosovën", Prishtina: Republika e Kosovës, 2014, në: <http://mmp-h->

## Buxheti i përgjithshëm

Tabela I përmban buxhetin e përgjithshëm të MMPH-së për vitet 2014-2019.<sup>14</sup> Në përgjithësi, MMPH-ja ka paraparë rritje të buxhetit të saj për vitin 2017. Megjithatë, ajo ka paraparë ulje në kategorinë ekonomike: paga dhe mëditje.

Viti		Puno njësit	Buxheti total	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transfertat	Investimet kapitale
2014	Të buxhetuara	293	€47,785,026	€1,442,857	€1,287,008	€97,906		€44,957,255
	Të shpenzuara		€44,967,148	€1,613,389	€1,610,134	€45,763		€41,697,861
	% e buxhetit të përdorur		94%	112%	125%	47%		93%
2015	Të buxhetuara	293	€38,353,185	€1,834,195	€1,223,957	€83,220		€35,211,813
	Të shpenzuara		€38,126,646	€1,817,788	€1,510,531	€41,701		€34,756,626
	% e buxhetit të përdorur		99%	99%	123%	50%		99%
2016	Të buxhetuara	335	€39,173,728	€2,138,187	€1,118,081	€83,220	€190,000	€35,644,240
	Të shpenzuara (Jan. deri në Mar.)	301 <sup>15</sup>	€7,975,979	€499,014	€260,221	€6,637		€7,210,107
	% e buxhetit të përdorur		20%	23%	23%	8%	0%	20%
2017	Të kërkuara	335	€3,247,122	€2,045,821	€1,118,081	€83,220		
2018	Të parashikuara	335	€3,256,453	€2,055,152	€1,118,081	€83,220		
2019	Të parashikuara	335	€3,256,453	€2,055,152	€1,118,081	€83,220		

### Pagat dhe mëditjet në MMPH

Në pajtim me Ligjin e ri për Barazi Gjinore, gratë dhe burrat duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në të gjitha organet vendimmarrëse në të gjitha institucionet publike (e përcaktuar si 50% e secilës gjini).<sup>16</sup> Tabela 2 paraqet punonjësit e MMPH-së që punojnë në administratën qendrore, të ndarë sipas gjinisë dhe nivelit të pagesës. Kjo tabelë ilustron se gratë janë të nën-përfaqësuar në MMPH në të gjitha nivelet, e veçanërisht në nivelin e pagave më të larta, ku gratë përbëjnë vetëm 20% të të gjithë punonjësve. Në total, gratë përbëjnë 37.8% të të gjithë punonjësve të MMPH-së. Pjesërisht si pasojë e nën-përfaqësimit të grave në pozitat vendimmarrëse, gratë kanë përfituar shumë më pak sesa burrat nga kategoria ekonomike paga dhe mëditje, duke marrë 38.5% nga kjo kategori ekonomike në vitin 2016.

Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201-400	72	56 (78%)	€18,325 (76%)	16 (22%)	€5,771 (24%)	€24,096
401-600	154	81 (53%)	€39,056 (54%)	73 (47%)	€33,810 (46%)	€72,865
600+	18	14 (78%)	€6,740 (71%)	4 (22%)	€2,740 (29%)	€9,481
<b>Totali</b>	<b>244<sup>18</sup></b>	<b>151 (62%)</b>	<b>€64,121 (60%)</b>	<b>93 (38%)</b>	<b>€42,321 (40%)</b>	<b>€106,442</b>

[rks.org/repository/docs/Strategjia\\_Korniz%C3%AB\\_p%C3%ABr\\_Ndryshime\\_Klimatike\\_p%C3%ABr\\_Kosov%C3%AB\\_1902\\_2014\\_FINAL\\_81170.pdf](https://rks.org/repository/docs/Strategjia_Korniz%C3%AB_p%C3%ABr_Ndryshime_Klimatike_p%C3%ABr_Kosov%C3%AB_1902_2014_FINAL_81170.pdf).

<sup>14</sup> Në këtë tabelë, të dhënat buxhetore për vitin 2014 janë nxjerr nga Ligji për Buxhetin e vitit 2014. Të dhënat e tjera janë nga drafti i parë i buxhetit për vitin 2017 si dhe nga raportet e shpenzimeve për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të ofruara nga udhëheqësi i Divizionit për Financa dhe Buxhet në MMPH. Investimet e buxhetuara kapitale janë nga Ligji për Buxhetin e vitit 2014, 2015, dhe 2016. Në këtë tabelë, shpenzimet e MMPH-së përfshijnë donacionet dhe kreditë për tërë Ministrinë. Donacionet kanë arritur shumën prej rreth €519,960 në 2014, €588,676 në 2015, dhe €67,984 në 2016. Kreditë kanë arritur shumën prej rreth €510,391 në 2014, €1,756,619 në 2015, dhe €40,353 në 2016.

<sup>15</sup> Kjo përfshin edhe punonjësit e Agjencisë Kadastrale.

<sup>16</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-020, neni 6.8.

<sup>17</sup> Të siguruara për RrGGK-në nga MMPH-ja, më 8 gusht 2016.

Pra, MMPH aktualisht nuk realizon detyrimet e saj ligjore për të siguruar përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.

# i zyrtarëve			Shuma e shpenzuar		
Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali
48 (37%)	82 (63%)	130	€28,151 (29%)	€68,596 (71%)	€ 96,747

Tabela 3 tregon numrin e zyrtarëve të MMPH-së që kanë udhëtuar jashtë Kosovës në vitin 2015, të ndarë sipas gjinisë. Zyrtarët e përfshirë në udhëtime ndërkombëtare kanë të drejtë në mëditje me një normë të caktuar. Këto fonde vijnë nga kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.<sup>19</sup> Nga 130 zyrtarë të cilët në vitin 2015 kanë marrë pjesë në vizita zyrtare, 63.1% ishin burra dhe 36.9% ishin gra. Pra, burrat kanë marrë pjesë më shumë në vizita zyrtare sesa gratë. Në total, €96,747 janë shpenzuar për mëditje në vitin 2015. Gratë kanë marrë 29.1% të kësaj shume, ndërsa meshkujt 70.9%.<sup>20</sup> Në vitin 2015, gjithsej €1,510,531 janë shpenzuar për mallra dhe shërbime (shih tabelën 1). Që do të thotë se gratë kanë marrë 1.9% nga këto fonde për mëditje, ndërsa burrat kanë marrë 4.5% për qëllimin e njëjtë.<sup>21</sup>

Më tej, RrGGK i ka ndarë këto të dhëna sipas vendit ku kanë udhëtuar zyrtarët. Tabela 4 paraqet numrin e vizitave të bëra nga gratë dhe burrat; disa zyrtarë kanë marrë pjesë në disa vizita. Një përqindje më e lartë e burrave kanë marrë pjesë në vizita zyrtare në rajon (67%) si dhe në vizita ndërkombëtare (70%) sesa gratë. Mëditjet për vizita ndërkombëtare janë më të larta sesa ato për vizita rajonale, gjë që mund ta shpjegojë pjesërisht pse burrat kanë marrë një përqindje më të lartë të mëditjeve sesa gratë (shih tabelën 3).

Rajonale			Ndërkombëtare		
Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali
86 (33%)	171 (67%)	257	54 (30%)	124 (70%)	178

### Investimet kapitale

Tabela 5 ilustron projektet e investimeve kapitale të cilat MMPH-ja i ka planifikuar për vitet 2017-2019. Këto investime kapitale, të bashkë-financuara me komuna, janë iniciuar nga komunat. Komunat kanë dërguar kërkesa për projekte për investime kapitale në Ministri, e cila i dorëzon këto kërkesa në qeveri para se Ministria e Financave të hartojë ligjin për buxhet. Komunat janë të detyruara të zhvillojnë konsultime publike para se të përzgjedhin projektet për investime kapitale. Megjithatë, investimet e planifikuara të renditura në tabelën 5 nuk ishin paraprirë nga konsultimet publike.<sup>22</sup> Shumica e projekteve janë vazhdim i punimeve që kanë filluar në vitet paraprake. Vetëm dy projekte të reja për investime kapitale janë planifikuar për vitin 2017: Projekti për Bimë, Kafshë, dhe Inventarë të Habitave Natyrore, si dhe Projekti për Fabrikën e Ujërave të Zeza në Pejë.

Departament i/agjencia	Emri i projektit	2017 Total	Parashikuar për vitin 2018	Parashikuar për vitin 2019	2017-2019 Total
Departament i për	Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive të personave të kthyer	€713,500	€1,000,000	€1,000,000	€2,713,500

<sup>18</sup> Kjo nuk përfshinë punonjësit e Agjencisë Kadastrale.

<sup>19</sup> Korrespondenca me e-mail midis RrGGK dhe udhëheqësit të Departamentit për Financa, 14 shtator 2016.

<sup>20</sup> Të llogaritura nga RrGGK me të dhënat e ofruara nga MMPH-ja të cilat përmbajnë emrat dhe shumatat e shpenzuara për secilin zyrtar.

<sup>21</sup> Të llogaritura nga RrGGK.

<sup>22</sup> Korrespondenca me e-mail midis RrGGK dhe udhëheqësit të Divizionit për Buxhet dhe Financa, 14 shtator 2016.

Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim	Memoriali "Baza e Parë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së)" Lladrovç, Podujevë	€214,000	€0	€0	€214,000
	Krijimi i bazës së të dhënave për menaxhim të kërkesave për banim	€20,000	€20,000	€20,000	€60,000
	Plani rregullues dhe ndërtimi i zonës së veçantë dhe të mbrojtur të rezistencës	€30,000	€30,000	€30,000	€90,000
	Ndërtimi i Memorialit "Agim Zhitia", Lluga, Podujevë	€200,000	€157,759	€0	€357,759
Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit	Bimët, Kafshët, Inventari i Habitave Natyrore	€240,000	€0	€0	€240,000
	Planifikimi i zonave të gjelbra në Varrezat në Llukë	€300,000	€300,000	€300,000	€900,000
	Ndërtimi i një objekti për deponim të përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme	€200,000	€800,000	€1,000,000	€2,000,000
	Ndërtimi i depos komunale në rajonin e Pejës	€200,000	€1,000,000	€0	€1,200,000
	Pastrimi i lumit Lepenc nga mbeturinat	€83,000	€0	€0	€83,000
	Ndërtimi i depos për materiale të ngurta në Prishtinë	€500,000	€1,000,000	€0	€1,500,000
Departamenti i Ujërave	Fabrika e ujërave të zeza në Pejë	€3,800,000	€0	€0	€3,800,000
	Rregullimi i shtratit të lumit Bistrica, Pejë	€200,000	€0	€0	€200,000
	Projekti i ujësjellësit në Drenas	€29,187	€0	€0	€29,187
	Akumulimi i ujit/Liqeni në Ibër Lepenc - Mitrovicë	€1,000,000	€337,182	€0	€1,337,182
	Rregullimi i shtratit të lumit Toplluha në Suharekë	€100,000	€100,000	€0	€200,000
	Rregullimi i kanalit të ujitjes Dobrushë-Kashicë-Saradran, Istog	€54,156	€0	€0	€54,156
	Kanalizimi në fashtin Raushiq	€100,000	€0	€0	€100,000
	Projekti për sistemin e ujërave të zeza dhe rregullimin e infrastrukturës së lumit Bistrica në Prizren	€1,400,000	€0	€0	€1,400,000
	Ndërtimi i kanalizimit në Deçan	€160,000	€0	€0	€160,000
	Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc në Kaçanik	€188,345	€0	€0	€188,345
	Rehabilitimi i objektit të ujësjellësit dhe kapacitetit të ujit në 9 fshatra në Kaçanik	€500,000	€169,160	€0	€669,160
	Rregullimi i shtratit të lumit Krena në Gjakovë	€200,000	€20,000	€0	€220,000
	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Runik, Skënderaj	€200,000	€0	€0	€200,000
	Rregullimi i shtratit të lumit Drenica në Drenas	€300,000	€300,000	€300,000	€900,000
Departamenti i Shpronësimit	Shpronësime	€24,997,354	€36,828,229	€51,797,330	€113,622,913
Fshati Hade	Fshati Hade	€100,000	€150,000	€50,000	€300,000

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)	Mirëmbajtja e rrjetit të stacioneve për monitorim të ajrit	€100,000	€100,000	€100,000	€300,000
	Mirëmbajtja e stacioneve hidrometrike të Kosovës sipas pellgjeve	€20,000	€20,000	€20,000	€60,000
	Furnizimi i Labororit të Institutit Hidrometeorologjik me materiale laboratorike	€20,000	€20,000	€20,000	€60,000
	Avancimi i rrjetit ekzistues meteorologjik dhe automatizimi i tij	€40,000	€20,000	€20,000	€80,000
	Blerja e materialeve të lëvizshme (motorëve për teren) për nevojat e rojave të parqeve	€20,000	€0	€0	€20,000
	Shënjimi dhe digitalizimi i zonave natyrore të mbrojtura	€10,000	€0	€0	€10,000
	Ruajtja dhe zhvillimi i qëndrueshmërisë së Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna	€30,000	€40,000	€40,000	€110,000
	Blerja dhe instalimi i softuerit qendror dhe i analizuesve për rrjetin e stacioneve	€40,000	€20,000	€20,000	€80,000
	Funksionalizimi i bifurkacionit të lumit Nerodime	€10,000	€0	€0	€10,000
	Blerja e automjeteve për AMMK	€0	€60,000	€0	€60,000
Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK)	Matjet gravimetrike relative	€60,000	€60,000	€60,000	€180,000
	Zgjerimi i bazës së të dhënave (harduer + softuer)	€100,000	€150,000	€150,000	€400,000
	Aeroincizimi	€50,000	€250,000	€0	€300,000
	Rindërtimi i informatave kadastrale (ZKK-të me shumicë të pakicave)	€300,000	€200,000	€200,000	€700,000
	Zgjerimi i intranetit të ZKK-ve me module të reja	€5,000	€5,000	€5,000	€15,000
	Skanimi i dokumenteve të arkivës	€100,000	€100,000	€200,000	€400,000
	Mirëmbajtja e sistemit informatik kadastral të tokës së Kosovës	€167,000	€167,000	€167,000	€501,000
	Kadastru i ndërtesave (Zyrat Kadastrale Komunale - ZKK-të me shumicë të pakicave)	€100,000	€75,000	€0	€175,000
	Zhvillimi i sistemit informatik kadastral të tokës së Kosovës	€250,000	€0	€0	€250,000
Zhvillimi i Gjeoportalit	€25,000	€0	€0	€25,000	
<b>Totali</b>	<b>€37,476,542</b>	<b>€43,499,330</b>	<b>€55,499,330</b>	<b>€136,475,201</b>	

### Objektivat e rekomanduara

1. Të përmirësohet niveli i pasqyrimin gjinorë, duke përfshirë nevojat dhe interesat e ndryshme të grave dhe burrave, në politikat mjedisore dhe në planifikimin urban.
2. Kur ka vende të lira të punës, të rritet përqindja e grave që punojnë në MMPH gradualisht, prej 37,8% në vitin 2016, duke përfshirë pozitave vendimmarrëse, duke arritur në këtë mënyrë progres drejt shpenzimeve të barabarta për gra dhe burra.
3. Të përmirësohet mbledhja e të dhënave që kanë të bëjnë me udhëtimet zyrtare dhe mëditjet.
4. Të rriten shpenzimet gradualisht çdo vit për mëditje për gra, të cilat në vitin 2015 janë 29,1%.

## Aktivitetet e rekomanduara

1. Të kryhen analiza gjinore me qëllim të sigurimit të informatave në të ardhmen për strategjitë dhe planet e veprimit për kompetencat e MMPH-së, duke përfshirë zyrtaren për barazi gjinore (ZBGj) dhe ekspertë gjinor të jashtëm në procesin e hartimit. Nëse kjo do të kryhej nga ZBGj-ja dhe anëtarët e grupit punues, kjo analizë nuk do të kishte kosto shtesë për Drejtorinë. Për çështje specifike të cilat kërkojnë hulumtime dhe informata të mëtejme, Drejtoria mund të alokojë fonde shtesë për të kontraktuar ekspertë për çështje gjinore.
2. Të rishikohen draft politikat dhe planet e veprimit për të siguruar përfshirjen e gjinisë në kuadër të tyre në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore. Kjo detyrë do të duhet të kryhet për çdo politikë dhe plan veprimi nga ana e ZBGj-së dhe nuk do të duhet të ketë kosto shtesë për Ministrinë.
3. Gjatë zbatimit të politikave ekzistuese, të synohet përfshirja e perspektivës gjinore gjatë fazave të zbatimit, monitorimit, dhe vlerësimit. Në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, kjo duhet të jetë pjesë e përgjegjësive të rregullta të të gjithë zyrtarëve dhe nuk do të duhej të ketë kosto shtesë për Ministrinë.
4. Neni 5 i Ligjit për Barazi Gjinore kërkon nga institucionet publike që të përdorin veprime afirmative me qëllim të adresimit të pabarazive ekzistuese gjinore. Në përputhje me këtë nen, MMPH-ja mundet dhe do të duhej të përdorë masa afirmative në angazhimin e personave të rinj në rastet kur ka konkurse për vende pune. Këto masa afirmative, sipas Ligjit për Barazi Gjinore, nuk përbëjnë diskriminim dhe do të përdoren vetëm përkohësisht deri sa të adresohen pabarazitë ekzistuese gjinore. Kjo nuk do të shkaktojë kosto shtesë për Ministrinë dhe do të jetë në përputhje me detyrimet e saj ligjore sipas Ligjit për Barazi Gjinore.
5. Të krijohet një bazë e të dhënave, të mirëmbahet, dhe të përdoret për të analizuar rregullisht të dhënat e kategorizuara sipas gjinisë për zyrtarët që marrin pjesë në udhëtimet zyrtare. Mbajtja e statistikave sipas gjinisë është detyrim ligjor sipas Ligjit për Barazi Gjinore.<sup>23</sup> Kjo mund të jetë një detyrë e rregullt e një punonjësi ekzistues (p.sh., e ZBGj-së në bashkëpunim me Departamentin e Financave), pasi që kjo kërkon vetëm pak kohë pasi që MMPH-ja i bën pagesat për mëditje. Kjo nuk do të paraqesë kosto shtesë.
6. Të inkurajohen të gjitha departamentet dhe divizionet që të sigurojnë një baraspeshë gjinore përkritazi me udhëtimet zyrtare, me qëllim që të ketë shpenzime më të baraspeshuara për mëditje për gratë dhe për burrat. Kjo nuk do të kërkojë burime shtesë, por alokim më të mirë të burimeve siç parashihet me Ligjin për Barazi Gjinore.

## Administrata qendrore

Linja buxhetore e Administratës Qendrore përfshinë buxhetet për Divizionin e Buxhetit dhe Financave dhe për Zyrën e Ministrit. Buxheti parashihet të ketë një zvogëlim të lehtë në vitin 2017, më saktësisht për paga dhe mëditje. Megjithatë, numri i punonjësve pritet të mbetet i njëjtë.

Në total, 68 persona punojnë në këtë Departament dhe divizionet e tij. Në përgjithësi, gratë (44%) dhe burrat (56%) kanë përfaqësim të mirë baraspeshuar në këtë Departament. Gratë marrin rreth 45% të shpenzimeve dhe burrat 56%. Po ashtu, gratë dhe burrat kanë pjesëmarrje të barabartë në nivelin më të lartë të pagave, megjithëse burrat marrin pak më shumë nga shpenzimet e këtij niveli (58%). Në pagat e nivelit të mesëm, gratë përbëjnë 58% të punonjësve dhe marrin 57% të shpenzimeve. Në pagat e nivelit më të ulët, burrat tejkalojnë gratë ndjeshëm në aspektin e numrit, ku përbëjnë 79% të punonjësve dhe marrin 78% të shpenzimeve.

---

<sup>23</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Neni 5.1.8



Tabela 6. Punonjësit e Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme sipas gjinisë dhe nivelit të pagës në periudhën Jan. - Gush. 2016<sup>24</sup>

Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201-400	24	19 (79%)	€77,388 (78%)	5 (21%)	€22,039 (22%)	€99,428
401-600	38	16 (42%)	€93,040 (43%)	22 (58%)	€123,150 (57%)	€216,190
600+	6	3 (50%)	€35,100 (58%)	3 (50%)	€25,533 (42%)	€60,633
<b>Totali</b>	<b>68</b>	<b>38 (56%)</b>	<b>€205,529 (55%)</b>	<b>30 (44%)</b>	<b>€170,722 (45%)</b>	<b>€376,250</b>

## Divizioni i Burimeve Njerëzore

Divizioni i Burimeve Njerëzore koordinon planifikimin e burimeve njerëzore dhe menaxhon rekrutimin e personelit. Ai është përgjegjës për zbatimin e procedurave të rekrutimit, procedurat e përzgjedhjes, procesimin e ankesave, kërkesat për pushim, vlerësimin e performancës dhe hartimin e planeve të trajnimit për personel.<sup>25</sup> Duke marrë parasysh mandatin e tij, ky Divizion duhet t'i mbështetë departamentet dhe divizionet tjera në zbatimin efektiv të masave afirmative të parapara me Ligjin për Barazi Gjinore gjatë procedurave të rekrutimit, avancimit, dhe angazhimit.

## Divizioni për Buxhet dhe Financa

Divizioni për Buxhet dhe Financa është përgjegjës për përgatitjen e propozim-buxhetit dhe koordinimin e proceseve të buxhetit për të gjitha strukturat administrative në Ministri. Ai siguron që të gjitha shpenzimet të jenë në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat buxhetore. Gjithashtu monitoron dhe raporton ekzekutimin e buxhetit.<sup>26</sup>

Ky Divizion luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e Ministrisë për të zbatuar detyrimet e saj përkitazi me BPGj-në, siç përcaktohet në Ligjin për Barazi Gjinore. Gjithashtu siguron që të gjitha departamentet dhe divizionet në Ministri të dorëzojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe t'i përdorin ato për të siguruar informata për planifikimin e buxheteve të tyre vjetore, duke përfshirë edhe identifikimin e treguesve të performancës sipas gjinisë. Ky Divizion gjithashtu duhet të sigurojë zbatimin e udhëzimeve të përcaktuara nga Ministria e Financave, duke përfshirë referencat në BPGj si dhe përfshirjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë në kërkesat buxhetore.<sup>27</sup>

### Objektivat e rekomanduara

1. Të përmirësohet mjedisi për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore duke instaluar politika dhe praktika për përdorimin e veprimeve afirmative gjatë angazhimit dhe avancimit të punonjëse, drejt sigurimit të një baraspeshe gjinore në kuadër të Ministrisë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.
2. Të përmirësohet zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, sipas Ligjit për Barazi Gjinore.

### Aktivitetet e rekomanduara

1. Të vazhdohet me rritjen e përqindjes së gjinisë së nën-përfaqësuar të punësuar në secilin nivel pagash, për çdo vit, deri në përmbushjen e kërkesës ligjore prej 50% të përfaqësimit në të gjitha nivelet e pagesës. Atëherë kur ka konkurse për vende të lira të punës, kjo mund të arrihet përmes veprimeve afirmative në procedurat e punësimit, siç parashikohet me Ligjin për Barazinë Gjinore.

<sup>24</sup> Të dhënat për pagat mujore janë ofruar nga Divizioni i Personelit. Llogaritjet e pagave vjetore dhe rrumbullakimi i numrave është bërë nga RrGGK.

<sup>25</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimin Hapësinor, Neni 34.

<sup>26</sup> Po aty, neni 35.

<sup>27</sup> Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, Qarkorja Buxhetore 2016/02, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20150909113719743.pdf>.

2. Të organizohen dhe të koordinohen trajnime për personelin e MMPH-së, nga ekspertët e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, me qëllim që Ministria të mund të përmbushë detyrimet ligjore sipas Ligjit të ri për Barazinë Gjinore. Këtu përfshihet edhe kujdesi që trajnimi për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor të përfshihet në trajnimin fillestar që ofrohet për punonjësit e rinj. Pasi që modulet e trajnimeve ekzistojnë, kjo do të paraqiste kosto të vogël ose zero për Ministrinë.
3. Të bashkëpunojë ngushtë me ZBGj-në, departamentet tjera, dhe divizionet për të integruar gjininë në kornizën afatmesme të shpenzimeve, si dhe në aneksin e buxhetit vjetor, duke përfshirë edhe në analizën e gjendjes, objektivave, aktiviteteve, dhe treguesve të performancës. Kjo duhet të bazohet në analizë të tendencave të kaluara, duke përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë. Kjo nuk do të paraqesë kosto shtesë dhe do të jetë pjesë e përmbushjes së përgjegjësisë ligjore të Ministrisë sipas Ligjit për Barazi Gjinore.

## Departamenti i Prokurimit

Departamenti i Prokurimit është i obliguar të zhvillojë procedurat e prokurimit në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës.<sup>28</sup> Ai është përgjegjës për përgatitjen, koordinimin dhe zbatimin e planit vjetor të Ministrisë lidhur me prokurimin publik. Vendosë për metodologjinë e prokurimit dhe procedurat për vlerësimin e çmimeve.<sup>29</sup> Buxheti i Departamentit të Prokurimit përfshihet në buxhetin e Administratës Qendrore. Ky departament nuk ka ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë, pavarësisht kërkesës.

Në nivel ndërkombëtar dhe në Kosovë janë ndërmarrë disa hapa në drejtim të integritetit të “aspekteve sociale” në proceset ose operacionet e prokurimit. Si term, “prokurimi publik i përgjegjshëm në aspektin social” nënkupton operacione të prokurimit të cilat marrin parasysh aspektet sociale, duke përfshirë promovimin e barazisë gjinore nën ombrellën e promovimit të mundësive për punësim.<sup>30</sup> Kjo formë e intervenimit publik mund të stimulojë integritetin e grupeve të caktuara dhe të çojë më tej barazinë gjinore. Në praktikë, kjo nënkupton që udhëzimet e prokurimit mund të hartohen në atë mënyrë që të inkurajojnë bizneset e kontraktuara ose të kërkojnë nga to që të kenë një baraspeshë më të madhe në strukturat e tyre të punonjësve. Mund të vendosjen kritere të qarta lidhur me përqindjen e punonjësve dhe punonjësve që punojnë në biznesin e kontraktuar.

Në Kosovë, Ligji nr. 05/L-068, për ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 ka shtuar që “Autoriteti kontraktues mund të vendosë, ndër të tjera, kushte specifike në kontratë të cilat lejojnë që objektivat sociale të merren parasysh.”<sup>31</sup> Në mesin e tyre është “detyrim për të zbatuar, gjatë ekzekutimit të kontratës, masat që janë projektuar për të nxitur barazinë midis burrave dhe grave apo diversitetit në baza tjera.”<sup>32</sup> Kjo do të thotë që MMPH-ja, si autoritet kontraktues, tani mundet që ligjërisht të vendosë masa afirmative drejt inkurajimit të bizneseve me pronare gra dhe/ose bizneseve që kanë më shumë punëtore femra të aplikojnë; ose MMPH-ja mund të sigurojë që si gratë, ashtu edhe burrat të përfitojnë nga vendet e punës të krijuara përmes projekteve të financuara nga qeveria. Derisa komunat janë përgjegjëse për kontraktimin e kompanive për realizimin e projekteve të investimeve kapitale,<sup>33</sup> në proceset e prokurimit për të cilat Ministria është përgjegjëse ekziston mundësia që barazia gjinore të avancohet më tej përmes prokurimit.

<sup>28</sup> Republika e Kosovës, MMPH, Departamenti i Prokurimit, marrë nga: <http://mmp-h-rks.org/sq/Departamenti-i-Prokurimit>.

<sup>29</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 39.

<sup>30</sup> Komisioni Evropian, *Blerja Sociale: Udhëzim lidhur me konsiderimin e aspekteve sociale në prokurimin publik, Luksemburg*, 2010, f. 7, marrë nga: <http://www.bassetlaw.gov.uk/media/29130/BuyingSocial.pdf>.

<sup>31</sup> Republika e Kosovës, Ligji nr. 05/L-068, për ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-068%20sh.pdf>.

<sup>32</sup> Po aty, neni 17.

<sup>33</sup> Intervistë e RrGGK-së me udhëheqësin e Departamentit të Financave, 21 prill 2016.

## Divizioni për Komunikim me Publikun

Divizioni për Komunikim me Publikun propozon, harton, dhe siguron zbatimin e planeve të komunikimit. Ai po ashtu organizon konferencat për medie dhe përgatitjen e publikimeve. Për më tepër, ai koordinon kërkesat për qasje në dokumente publike.<sup>34</sup> Buxheti i divizionit përfshihet në buxhetin e Administratës Qendrore. RrGGK nuk ka marrë të dhëna të ndara sipas gjinisë nga ky divizion. Megjithatë, ky divizion mund të merr në konsideratë perspektivën gjinore në disa aspekte të punës së tij, siç rekomandohet më poshtë.

### Objektivat e rekomanduara

1. Të sigurojë që perspektiva gjinore të integrohet në kuadër të planeve të komunikimit dhe në materialet për publikun.
2. Të inkurajohen kompanitë dhe bizneset e kontraktuara të cilat i ekzekutojnë projektet investuese të punësojnë gra dhe burra në mënyrë të barabartë në përpunime me Ligjin e ndryshuar për Prokurimin Publik.

### Aktivitetet e rekomanduara

1. Të përfshihen të dhënat e ndara sipas gjinisë në komunikimet me shtypin. Të hartohen plane dhe materiale të komunikimit ashtu që ato t'i marrin parasysh interesat, nevojat për komunikim, dhe prioritetet potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave. Të sigurohet që ilustrimet të mos i përforcojnë rolet tradicionale gjinore ose të mos i lënë jashtë gratë apo burrat. Planet e komunikimit mund t'i marrin në konsideratë mënyrat më të mira të ofrimit të informatave për gra dhe burra, duke marrë parasysh mënyrat, kohën dhe format e ndryshme të komunikimit.
2. Të vendosen veprime afirmative në dokumentet e prokurimit me qëllim të inkurajimit të bizneseve me pronare gra dhe/ose bizneseve me më shumë punëtorë femra që të aplikojnë; të sigurohet që si gratë, ashtu edhe burrat përfitojnë nga vendet e punës të krijuara nëpërmjet projekteve të financuara nga qeveria.

## Departamenti Ligjor

Departamenti Ligjor ofron mbështetje ligjore në hartimin e legjislacionit që ka të bëjë me punën e Ministrisë. Ai siguron harmonizimin me legjislacionin si dhe përafrimin me legjislacionin e *acquis të Bashkimit Evropian (BE-së), si dhe me ligjet e tjera të zbatueshme në Kosovë*.<sup>35</sup> Ky departament përbëhet nga Divizioni për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit,<sup>36</sup> dhe Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, të Mbështetjes Ligjore, dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit.<sup>37</sup>

Buxheti i Departamentit Ligjor përfshihet në buxhetin e Administratës Qendrore. Ky departament dhe divizionet e tij nuk kanë ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë. Prandaj, është e paqartë se a kanë bërë analiza gjinore me qëllim të sigurimit të informatave për politikën e propozuara dhe/ose a e kanë mbështetur zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore përmes këshillave dhe mbështetje ligjore.

<sup>34</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 38.

<sup>35</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 30.

<sup>36</sup> Divizioni për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit mbështet hartimin e legjislacionit të ri dhe siguron pajtueshmërinë me *acquis të BE-së* si dhe me ligjet e tjera të zbatueshme në Kosovë (Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 31).

<sup>37</sup> Ky divizion koordinon aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e legjislacionit. Ofron mbështetje ligjore, duke përfshirë vendimet, marrëveshjet, memorandumet, dhe kontratat e propozuara (Po aty, Neni 32.).

## Objektivat e rekomanduara

1. Të sigurohet që të gjitha ligjet dhe politikat e propozuara nga Ministria të bazohen në analiza gjinore dhe të integrojnë perspektivën gjinore në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.

## Aktivitetet e rekomanduara

1. Të bëhet integrimi gjinor në të gjitha ligjet, rregulloret, strategjitë, planet e veprimit, dhe dokumentet tjera, në përputhje me detyrimet që burojnë nga Ligji për Barazi Gjinore. Të gjitha politikat do të duhej të marrin në konsideratë nevojat dhe interesat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave, si dhe atë se si një politikë apo ligj i ri mund të ndikojë ndryshe te gratë e ndryshe te burrat. Të përfshihet ZBGj në shqyrtimin e të gjitha dokumenteve të reja ligjore dhe nën-ligjore, si dhe në pjesëmarrjen në grupet punuese. Kjo mund të lehtësojë integrimin gjinor pa kosto shtesë për këtë departament.
2. Të sigurohet që legjislacioni i ri i MMPH-së të jetë në harmoni të plotë kërkesat ndërkombëtare për barazi gjinore, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me anëtarësimin në BE. Legjislacioni i ri dhe ai ekzistues duhet të harmonizohet me *acquis* të BE-së për barazi gjinore si dhe me planin e ri të BE-së për barazi gjinore.<sup>38</sup> Kjo nuk do të duhej të kërkonte burime shtesë pasi që mund të kryhet si pjesë e detyrave të rregullta të këtij departamenti. Megjithatë, departamenti mund të merr në konsideratë kontraktimin e ekspertëve gjinor, sipas nevojës, për të mbështetur përmbushjen e këtyre detyrimeve.
3. Të kryhen rregullisht analiza gjinore për të gjitha ligjet, udhëzimet administrative, rregulloret dhe strategjitë ekzistuese. Të sigurohet pajtueshmëria e tyre me detyrimet ligjore që kanë të bëjnë me barazi gjinore në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin për Barazi Gjinore.

## Departamenti për Integritime Evropiane dhe Koordinim të Politikave

Departamenti për Integritime Evropiane dhe Koordinim të Politikave ofron mbështetje në koordinimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me procesin e integritimit evropian, duke përfshirë harmonizimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së. Ai mbështet shkëmbimin e informatave lidhur me procesin e integritimit evropian që ka të bëjë me mandatin e Ministrisë.<sup>39</sup> Ky departament përbëhet nga Divizioni për Integritim Evropian dhe Divizioni për Koordinim të Politikave. Buxheti i këtij departamenti përfshihet në buxhetin e Administratës Qendrore. RrGGK-ja nuk ka marrë të dhëna të ndara sipas gjinisë nga ky departament lidhur me shpenzimet për paga dhe mëditje dhe as për kategoritë tjera ekonomike, pavarësisht kërkesës.

Në kontekstin e anëtarësimit të Kosovës në BE, ky departament, ndër të tjera, do të duhej të ndërmerr hapa drejt avancimit të barazisë gjinore. Për shembull, një objektivë e fushës së tretë kryesore të Planit të ri të veprimit të BE-së për barazi gjinore 2016-2020 është "Gratë gëzojnë të drejta të barabarta për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në proceset e vendimmarrjes në çështjet klimatike dhe mjedisore".<sup>40</sup> Qeveria e Kosovës, duke përfshirë edhe këtë departament të MMPH-së, do të duhej të marrë në konsideratë edhe këtë gjatë ndërmarrjes së veprimeve drejt zbatimit të synimeve të BE-së përkitazi me barazinë gjinore.

---

<sup>38</sup> Komisioni Evropian, Plani i Veprimit për Barazi Gjinore, *Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi jetës së vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së 2016-2020*, Bruksel: 2015, marrë nga:

[https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/staff-working-document-gender-2016-2020-20150922\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/staff-working-document-gender-2016-2020-20150922_en.pdf).

<sup>39</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 27.

<sup>40</sup> Komisioni Evropian, Plani i Veprimit për Barazi Gjinore

## **Divizioni për Integritime Evropiane dhe Divizioni për Koordinim të Politikave**

Divizioni për Integritime Evropiane siguron përfshirjen e politikave të BE-së në MMPH në përputhje me *acquis të BE-së*. Ai mbështet zbatimin e kriterëve të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) në MMPH. Ky divizion është përgjegjës për përgatitjen e planeve të veprimit dhe dokumenteve për planifikim sektorial (DPS) për Instrumentin për Ndihmë Para-anëtarësimit (IPA). Në përputhje me planin e ri të BE-së për barazi gjinore, të gjitha dokumentet IPA duhet të pasqyrojnë një perspektivë gjinore, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë për treguesit dhe caqet. Kjo zbatohet për seksionet mjedisore të dokumenteve po ashtu, përkatësisht lidhur me atë se si çështjet mjedisore mund të ndikojnë te gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme dhe se si çështjet e tilla mund të adresohen. Duke marrë parasysh se mjedisi është një temë ndërsektoriale në të gjitha dokumentet IPA, duket e besueshme të sugjerohet që ky divizion po ashtu do të duhej t'i shqyrtojë dokumentet IPA nga të gjitha ministritë e linjës me qëllim që të sigurojë se ato i përmbushin kriteret e BE-së përkitazi me mjedisin.

Divizioni për Koordinim të Politikave koordinon procesin e hartimit të dokumenteve strategjike të MMPH-së, duke përfshirë edhe procesin e planifikimit të buxhetit. Ky divizion po ashtu ofron të dhëna dhe informata për planin vjetor të punës së Ministrisë, duke siguruar që ai të jetë në përputhje me kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe me dokumente tjera strategjike. Ai monitoron dhe raporton për zbatimin e planit zhvillimor strategjik të Ministrisë.<sup>41</sup>

Nga shqyrtimi i disa prej strategjive dhe planeve strategjike të MMPH-së del se ato nuk janë mjaftueshëm të ndjeshme nga aspekti gjinor. Për shembull, "Strategjia Mjedisore e Kosovës (SMK) dhe Planin Kombëtar i Veprimit Mjedor (PKVM) 2011-2015" nuk ka objektiva, aktivitete, dhe tregues të ndara sipas gjinisë.<sup>42</sup>

### **Objektivat e rekomanduara**

1. Të përmirësohet perspektiva gjinore në kuadër të DPS-ve dhe dokumenteve të veprimit të IPA-s, duke përfshirë seksionet mjedisore të dokumenteve të IPA-s të ministrive tjera, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore dhe planin e ri të veprimit për barazi gjinore të BE-së.
2. Të sigurohet integrimi gjinor në të gjitha dokumentet e politikave, duke përfshirë edhe versionin e ri të Strategjisë Mjedisore të Kosovës (SMK) dhe Planin Kombëtar të Veprimit Mjedor (PKVM) 2011-2015.

### **Aktivitetet e rekomanduara**

1. Të bashkëpunojë me Zyrën e BE-së në Kosovë, ZBGj-në, Ministrinë e Integritimit Evropian, dhe ekspertët vendorë për të integruar gjininë në DPS-të dhe dokumentet e veprimit të IPA-s. Gjinia duhet të përmendet vetëm në seksionin "Çështje ndër-sektoriale". Por, ajo duhet të integrohet në tërë dokumentin. Kjo përfshinë sigurimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë në kuadër të analizës së situatës, në kornizën logjike, në treguesit e performancës, si dhe në seksionin mjedor. Kjo është pjesë e përgjegjësisë të burimeve njerëzore ekzistuese të këtij departamenti, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, dhe rrjedhimisht nuk do të duhej të ketë nevojë për burime shtesë.
2. Të sigurohet që të gjitha politikat dhe planet të përfshijnë perspektivën gjinore duke e përfshirë ZBGj-në në shqyrtimin e tyre, si dhe duke u konsultuar me ekspertë gjinor. Të përfshijë të dhëna të ndara sipas gjinisë në raportimin e rregullt për Planin Zhvillimor Strategjik të MMPH-së, si dhe për SMK e re dhe PKVM 2011-2015, në përputhje me kërkesat e Ligjin për Barazi Gjinore për të mbajtur dhe raportuar të dhëna të ndara sipas gjinisë.

<sup>41</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 29.

<sup>42</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, *Strategjia Mjedisore e Kosovës (SMK) dhe Planin Kombëtar i Veprimit Mjedor (PKVM) 2011-2015*, Prishtinë, marrë nga: 2011, marrë nga: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/REVISING\\_and\\_UPDATING\\_the\\_KOSOVO\\_ENVIRONMENTAL\\_STRATEGY\\_\(KES\).pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/REVISING_and_UPDATING_the_KOSOVO_ENVIRONMENTAL_STRATEGY_(KES).pdf).

## Njësia për të Drejtat e Njeriut

Njësia për të Drejtat e Njeriut jep rekomandime për Sekretarin e Përgjithshëm dhe për personelin në MMPH. Ajo gjithashtu vlerëson zbatimin e standardeve për të drejtat e njeriut në MMPH dhe merr pjesë në hartimin e ligjeve dhe politikave në përputhje me këto standarde.<sup>43</sup> Gjatë shqyrtimit të projekt ligjeve dhe politikave, kjo njësi mund të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të grave si të drejta të njeriut, në përputhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, si dhe të sigurojë marrjen në konsideratë të perspektivës gjinore, sipas nevojës. Njësia për të Drejtat e Njeriut është në kuadër të Sekretarit të Përgjithshëm, mirëpo ajo ka linjën e saj buxhetore në buxhetin e vitit 2016 si dhe draftin e parë të buxhetit për vitin 2017. Buxheti i saj ka qenë mjaft konsistent në vitin 2015 dhe 2016, dhe do të mbetet i njëjtë në vitet 2017-2018.

### Pagat dhe mëditjet

Siç paraqitet në tabelën 7, kjo njësi ka dy punonjëse. Prandaj, gratë marrin 100% të shpenzimeve në këtë kategori ekonomike.

Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201-400	1	0 (0%)	€0 (0%)	1 (50%)	€4,543 (100%)	€4,543
401-600	1	0 (0%)	€0 (0%)	1 (50%)	€6,645 (100%)	€6,645
<b>Totali</b>	<b>2</b>	<b>0 (0%)</b>	<b>€0 (0%)</b>	<b>2 (100%)</b>	<b>€11,188 (100%)</b>	<b>€11,188</b>

### Objektivat e rekomanduara

1. Të sigurohet marrja parasysh e të drejtave të njeriut dhe e perspektivës gjinore në projekt ligje dhe politika.
2. Me rastin e hapjes së konkurseve për vende të lira të punës, të rritet përqindja e burrave që punojnë në këtë njësi nga 0% në 50%, duke i baraspeshuar kështu shpenzimet midis burrave dhe grave.

### Aktivitetet e rekomanduara

1. Të shqyrtohen projekt ligjet dhe politikat nga perspektiva gjinore, duke i mbrojtur të drejtat e të gjitha gjinive.
2. Me rastin e hapjes së konkurseve për vende të lira të punës, të përdoren veprime afirmative në procedurat e punësimit për të inkurajuar më shumë meshkuj të aplikojnë.

## Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit propozon politika për mbrojtje mjedisore dhe ofron mbështetje përkitazi me përdorimin e burimeve natyrore. Ai gjithashtu kryen aktivitete administrative dhe profesionale drejt arritjes së anëtarësimit në konventa, traktate, organizata ndërkombëtare, dhe marrëveshje.<sup>44</sup> Ky departament përbëhet nga katër divizione: Divizioni për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor, Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale, Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate, dhe Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës. Në vazhdim mund të gjeni informata më të detajuara për secilin prej divizioneve.

<sup>43</sup> Qeveria e Kosovës, faqja e internetit e MMPH-së, marrë nga: <http://mmp-h-rks.org/sq/Nj%C3%ABsia-p%C3%ABr-t%C3%AB-Drejtat-e-Njeriut>.

<sup>44</sup> Qeveria e Kosovës, faqja e internetit e MMPH-së, marrë nga: <http://mmp-h-rks.org/sq/Departamenti-per-Mbrojtjen-e-Mjedisit>.

## Pagat dhe mëditjet

Siç tregon tabela 8, në këtë departament punojnë në përqindje mjaft të drejtë gratë (48%) dhe burrat (52%). Gjithashtu, shpenzimet për paga dhe mëditje për gra (46%) dhe burra (54%) janë të përafërta. Duke pas parasysh numrin e personelit në secilin nivel të pagës, ky departament dhe divizionet e tij ruajnë po ashtu një baraspeshë gjinore për aq sa është e mundur në secilin nivel të pagës.

Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201-400	1	0 (0%)	€0 (0%)	1 (100%)	€3,856 (100%)	€3,856
401-600	25	13 (52%)	€75,873 (54%)	12 (48%)	€65,774 (46%)	€141,647
600+	1	1 (100%)	€7,353 (100%)	0 (0%)	€0 (0%)	€7,353
<b>Totali</b>	<b>27</b>	<b>14 (52%)</b>	<b>€83,225 (54%)</b>	<b>13 (48%)</b>	<b>€69,631 (46%)</b>	<b>€152,856</b>

## Divizioni për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor

Divizioni për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor në bashkëpunim me institucione tjera propozon dhe siguron zbatimin e politikave që kanë të bëjnë me edukimin dhe ndërgjegjësimin mjedisor. Ai mbështet ngjarjet dhe analizat lidhur me ndërgjegjësimin, si dhe raportet e rregullta në këtë fushë.<sup>46</sup>

Tabela 9 paraqet numrin e nxënësve pjesëmarrës në ligjëratat për ngritjen e ndërgjegjësit, të organizuara nga ky divizion në shkollat fillore në vitet 2014 dhe 2015. Të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk ishin në dispozicion, megjithëse mund të supozohet se baraspesha gjinore pasqyrohet nga nxënësit në klasat pjesëmarrëse.

Megjithëse ky divizion kryen edhe aktivitete tjera në terren, nuk janë ofruar informata tjera për këto aktivitete ose për materialet e komunikimit që janë përdorur, pavarësisht kërkesës.

## Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale

Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale propozon politika që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga ndotja e shkaktuar nga industria. Ai gjithashtu monitoron dhe raporton për të drejtat dhe detyrimet në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.<sup>47</sup> Ky divizion vlerëson projektet që duhet të zbatohen në të ardhmen dhe atë se si ndotja e një projekti mund të ndikojë në popullatë. Divizioni i përdor analizat të bëra nga Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe

Tabela 9. Pjesëmarrja e nxënësve në ligjëratat për ndërgjegjësim mjedisor sipas komunave 2014-2015

Komuna	# i nxënësve	
	2014	2015
Mitrovicë	117	610
Kamenicë	135	0
Viti	125	0
Gjilan	119	500
Hani i Elezit	103	0
Malishevë	54	130
Vushtrri	122	93
Rahovec	71	0
Klinë	104	0
Suharekë	101	0
Glllogoc	132	87
Shtime	125	0
Lipjan	137	0
Prishtinë	0	875
Pejë	0	728
Ferizaj	0	635
Obiliq	0	227
Kaçanik	0	130
Gjakovë	0	258
Fushë Kosovë	0	110
Podujevë	0	89
Skënderaj	0	113
Istog	0	226
Junik	0	76
Prizren	0	115
Dragash	0	105
<b>Gjithsej</b>	<b>1445</b>	<b>5107</b>

<sup>45</sup> Divizioni i Personelit ka siguruar të dhëna për pagat mujore. Llogaritjet e pagave vjetore dhe rrumbullakimi i numrave është bërë nga RrGGK-ja.

<sup>46</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 8.

<sup>47</sup> Po aty, neni 9.



AMMK-ja për të identifikuar politikat dhe strategjitë që kanë të bëjnë me cilësinë e ajrit, mjedisit, dhe të ujit.<sup>48</sup>

Gjatë procesit të hartimit të strategjive dhe raporteve tjera, ky divizion historikisht nuk ka kryer analiza gjinore përkitazi me atë se si mund të ndikojnë zonat e ndotura të gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme. Në disa raste, ndikimi i ndotjes industriale, e në veçanti ndikimi i plumbit, të gratë shtatzëna ka qenë i konsiderueshëm.<sup>49</sup>

Mbajtja dhe përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë lidhur me gratë dhe burrat e ndryshëm që preken më së shumti nga ndotja industriale, si dhe i të dhënave të ndara sipas gjinisë për pronarët dhe menaxherët e kompanive të identifikuar që shkaktojnë ndotjen më të madhe industriale do të mund të lehtësonte përmirësimin e komunikimit me industrinë ndotëse të synuara, si dhe në vendosjen e prioriteteve lidhur me atë se cilat kompani do të duhej të trajtoheshin të parat duke u bazuar në ndikimin më të madh të tyre në gra dhe burra.

## Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate

Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate është përgjegjës për hartimin dhe sigurimin e zbatimit të politikave në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe me legjislacionin e BE-së lidhur me menaxhimin e mbeturinave, kimikateve, dhe produkteve biocide. Ai po ashtu merret me kërkesat për licencim, draft pëlqimet, si dhe draft lejet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë me politikat përkatëse për mbrojtje mjedisore.<sup>50</sup>

Ky divizion ka prodhuar pamfleta të papublikuara të cilat e paraqesin ndikimin e kimikateve të ndryshme në njerëz. Disa kimikate ndikojnë ndryshe të gratë e ndryshe të meshkujt. Pamfletat duhet të paraqesin informata të ndara sipas gjinisë kudo që është e mundur. Gjithashtu, ilustrimet në pamfleta duhet të paraqesin gratë dhe burrat, duke shmangur portretizimin e grave ose burrave në rolet tradicionale gjinore.

## Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës

Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës është përgjegjës për hartimin dhe sigurimin e zbatimit të politikave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës. Ai monitoron zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së natyrës. Po ashtu kontribuon në vlerësimin e projekteve për ekologji.<sup>51</sup>

Tabela 10 paraqet numrin e personave që kanë marrë pjesë në debatet publike për projektligjet mbi Parqet Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri" të ndarë sipas gjinisë. Të dhënat ilustrjnë se vetëm një numër i vogël i grave kanë marrë pjesë në këto debate publike në të tri komunat. Në Deçan, nga 50 pjesëmarrës, asnjë grua nuk ka marrë pjesë. Në Reçan, vetëm 19,2% e pjesëmarrësve ishin gra, ndërsa në Junik vetëm 23,8%. Kjo mund të nënkuptojë se ndoshta nevojat dhe interesat e veçanta të grave nuk janë marrë parasysh mjaftueshëm gjatë krijimit të projektligjit. Për më tepër, nga perspektiva e buxhetimit gjinor, kjo po ashtu sugjeron se burimet njerëzore të divizionit si dhe burimet tjera për programim (p.sh., konsultimet e organizuara nga ky divizion) janë shpenzuar më shumë në konsultime me burra sesa me gra.

Tabela 10. Pjesëmarrësit në debatet publike për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe parkun kombëtar "Sharri"			
Vendi	Gra	Burra	Totali
Junik: "Bjeshkët e Nemuna"	10 (24%)	32 (76%)	42
Deçan: "Bjeshkët e Nemuna"	0 (0%)	50 (100%)	50
Reçan: "Sharri"	5 (19%)	21 (81%)	26
Totali	15 (13%)	103 (87%)	118

<sup>48</sup> Shih për shembull: *Plani i Kosovës për veprim në mjedis* (i disponueshëm vetëm në gjuhën shqipe), marrë nga: [http://ammk-rks.net/repository/docs/Plani\\_i\\_Kosoves\\_per\\_Veprim\\_ne\\_Mjedis.pdf](http://ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_Kosoves_per_Veprim_ne_Mjedis.pdf).

<sup>49</sup> Diskutimi i RrGGK-së me udhëheqësin e divizionit, 5 maj 2016.

<sup>50</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 10.

<sup>51</sup> Po aty, neni 11.



## Objektivat e rekomanduara

1. Të përmirësohet institucionalizimi i edukimit mjedisor të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore për nxënësit parauniversitar, duke ulur kështu potencialisht shpenzimet për ngritjen e ndërgjegjësimit në të ardhmen.
2. Të rritet përdorimi i analizave gjinore në vendosjen e prioritetëve dhe trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me ndotjen industriale.
3. Të sigurohet që materialet e komunikimit për mbeturina dhe kimikate të synojnë gratë, burrat, djemtë dhe vajzat.
4. Të rritet pjesëmarrja e grave në konsultimet publike për hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit në të ardhmen, nga 12,7% për projektligjin për parqet kombëtare (si bazë) në 20%, në politikat dhe ligjet e tjera në të ardhmen.

## Aktivitetet e rekomanduara

1. Në mënyrë që të arrihet një qasje më efektive dhe me e qëndrueshme për ngritje të vetëdijesimit, Divizioni për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor do të duhej të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT-in) për të institucionalizuar edukimin mjedisor në kurrikulat e përhershme në arsimin parauniversitar, duke ulur kështu në mënyrë substanciale koston e përpjekjeve për ngritje të ndërgjegjësimit të fëmijët. Të sigurohet që kurrikulat të jenë të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore në përmbajtje, duke përfshirë edhe ilustrimet. Hartimi i kurrikulave mund të kërkojë fillimisht burime, të cilat mund të sigurohen përmes fondeve të IPA-s nëse ato harmonizohen me objektivat edukative që kanë të bëjnë me mbrojtjen mjedisore si pjesë e anëtarësimit në BE. Për trajnimin fillestar të mësimdhënësve, në konsultim me MASHT-in, mund të nevojiten disa fonde shtesë. Megjithatë, pas këtyre shpenzimeve fillestare, ky program do të mund të zhvillohej si pjesë e kurrikulave të rregullta pa krijuar shpenzime në të ardhmen për Ministrinë.
2. Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale mund të nxjerrë përfundime nga të dhënat e ndara sipas gjinisë lidhur me ndikimin e ndotjes industriale të gratë dhe burrat e ndryshëm (p.sh., në lokacione të ndryshme) dhe t'i përdorë këto informata për vendosjen e agjendës përkitazi me industrinë për të cilat vendosen prioritetet për ndërmarrjen e masave dhe adresimeve specifike.<sup>52</sup> Analizat e tilla gjinore do të duhej të ishin pjesë e përgjegjësive të rregullta të zyrtarëve në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore dhe, rrjedhimisht, nuk do të duhej të kishte nevojë për kosto shtesë. Për kontraktimin e studimeve specifike, divizioni mund të ndajë buxhet për ekspertizë gjinore.
3. Të bashkëpunohet me ZBGj-në dhe OSHC-të për të drejtat e grave me qëllim të integritimit gjinor në të gjitha broshurat, pamfletet dhe publikimet e tjera. Të sigurohet qasja si e grave, ashtu edhe e burrave në materialet për komunikim publik. Kjo nuk paraqet kosto shtesë.
4. Të sigurohet informimi i grave për debate publike dhe debatet të organizohen në kohën dhe në vende ku gratë mund të marrin pjesë. Të bashkëpunohet me OSHC-të e grave për informimin e grave rreth debateve publike dhe për inkurajimin e tyre që të marrin pjesë. Me planifikim të duhur, kjo mund të bëhet pa kosto shtesë për Ministrinë.
5. Të mbahen të dhëna të ndara sipas gjinisë për të gjithë pjesëmarrësit në ngjarje për ngritje të ndërgjegjësimit, në tryeza të rrumbullakëta, dhe në konferenca, siç kërkohet me Ligjin për Barazi Gjinore. Kjo do të ndihmojë në analizën e asaj se a përfitojnë gratë dhe burrat barabartë nga fondet e departamentit të ndara për ngjarje publike. Kjo detyrë mund të kryhet nga zyrtarët ekzistues në përputhje me detyrimet e tyre ligjore sipas Ligjit për Barazi Gjinore, pa kosto shtesë për Ministrinë.

---

<sup>52</sup> RrGGK-ja do të publikoj hulumtimin për ndotjen dhe shëndetin e grave dhe burrave në vitin 2016, i cili mund të jetë i dobishëm.

## Departamenti i Ujërave

Departamenti i Ujërave merret me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ujërat, duke u përqendruar në përdorimin e burimeve të ujërave dhe mbrojtjen e tyre nga ndotja. Departamenti i Ujërave përbëhet nga katër divizione:<sup>53</sup> Divizioni për Planifikim Strategjik,<sup>54</sup> Divizioni për Menaxhimin e Resurseve Ujore,<sup>55</sup> Divizioni për Pellgun Lumor Drini i Bardhë dhe Plava,<sup>56</sup> si dhe Divizionin për Pellgun Lumor Ibër, Moravë e Binçës dhe Lepenc.<sup>57</sup> Shpenzimet e departamentit për mallra dhe shërbime përdoren për nevojat në kuadër të këtij departamenti.<sup>58</sup> Nga viti 2014 deri në 2015, shpenzimet kapitale janë përdorur kryesisht për riparimin e shtretërve të lumenjve.<sup>59</sup>

### Pagat dhe mëditjet

Departamenti i Ujërave ka më shumë punonjëse (63%) sesa punonjës (38%) (tabela 11). Sa i përket shpenzimeve në kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve, pak më shumë janë shpenzuar për gra (59%) sesa për burra (41%).

Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201-400	1	0 (0%)	€0 (0%)	1 (100%)	€3,856 (100%)	€3,856
401-600	14	5 (36%)	€29,728 (37%)	9 (64%)	€50,022 (63%)	€79,750
600+	1	1 (100%)	€7,353 (100%)	0 (0%)	€0 (0%)	€7,353
<b>Totali</b>	<b>16</b>	<b>6 (38%)</b>	<b>€37,081 (41%)</b>	<b>10 (63%)</b>	<b>€53,879 (59%)</b>	<b>€90,960</b>

### Programet dhe aktivitetet

Thënë në përgjithësi, politikëbërësit që punojnë në çështjet ujore si një pasuri burimore e përbashkët mund të mos e shohin rëndësinë e shqyrtimit gjinor. Megjithatë, burrat dhe gratë mund të kenë kërkesa të ndryshme, qasje të ndryshme dhe kontroll të ndryshëm mbi burimet ujore. Gratë dhe burrat mund të kenë nivele të ndryshme të fuqisë, pasurisë, ndikimit, dhe mundësisë për t'i shprehur nevojat, shqetësimet dhe të drejtat e tyre.<sup>61</sup> Pa një perspektivë gjinore, politikëbërësit mund të mos e e kuptojnë ndikimin potencialisht të ndryshëm që menaxhimi dhe shfrytëzimi i ujit mund të ketë në gra

<sup>53</sup> Korrespondenca me ushtruesin e detyrës së drejtorit të departamentit, 29 qershor 2016.

<sup>54</sup> Divizioni për Planifikimin Strategjik kryen punë që kanë të bëjnë me planet dhe programet strategjike për shfrytëzim afatgjatë të ujit. Koordinon dhe administron zbatimin e politikave ujore në nivelin qendror dhe lokal. Ai po ashtu përgatitë planet e veprimit për shfrytëzim të qëndrueshëm të ujit dhe për mbrojtje të ujit. Kjo përfshinë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe bilateral lidhur ujërat (Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 17).

<sup>55</sup> Divizioni për Menaxhimin e Resurseve Ujore merret me çështjet juridike që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e ujit dhe fuqinë e ujit. Ai përcjellë zbatimin e dokumenteve strategjike lidhur me shfrytëzimin e ujërave në suaza të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik shoqëror. Gjithashtu mbikëqyrë shfrytëzimin e furnizimit publik me ujë, në bashkëpunim me ministritë, komunat, dhe institucionet (Po aty, neni 18).

<sup>56</sup> Divizioni për Pellgun Lumor Drini i Bardhë dhe Plava është përgjegjës për krijimin e një baze të të dhënave për këto pellgje, për menaxhimin e burimeve ujore në këto pellgje, për planifikimin e shfrytëzimit të ujit, për të vendosur për kompensimin për ndotjen e ujit, dhe për mbrojtjen e interesit publik. Ai bashkëpunon me institucionet përkatëse dhe kontrollon për kohësisht lejet hidro-ekonomike.

<sup>57</sup> Divizioni për Pellgun Lumor Ibër, Moravë e Binçës dhe Lepenc i kryen detyrat e njëjta, sikurse divizioni i sipërpërmendur, për këto tri pellgje (Po aty, neni 20).

<sup>58</sup> Korrespondenca e postës elektronike me RrGGK-në, 29 qershor 2016.

<sup>59</sup> Po aty.

<sup>60</sup> Të dhënat janë siguruar nga Divizioni i Personelit, në baza mujore. Llogaritjet e pagave vjetore dhe rumbullakimi i numrave është bërë nga RrGGK-ja.

<sup>61</sup> Sadhu, G. and Chakravarty, N., "Integrimi gjinor në menaxhimin e ujit," *Revista Ndërkombëtare e Publikimeve Shkencore dhe Kërkimore, vëllimi 2, botimi 11, f. 1, marrë nga:* <http://www.ijrsp.org/research-paper-1112/ijrsp-p1110.pdf>.

dhe burra. Siç ka vërejtur CAP-NET, vlerësimi se si e menaxhojnë ujin gratë dhe burrat mund të informojë këtë Departament se si:

- të shfrytëzojnë ujin në mënyrë më efektive dhe më të qëndrueshme;
- t'i ndajë përfitimet nga qasja në ujë në mënyrë më të barabartë;
- t'i maksimalizoj përfitimet socio-ekonomike nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i ujit;
- Në kontekstin e krizës ekonomike, të mundësojë shfrytëzim më efektiv të instrumenteve financiare dhe politikave kombëtare për t'i mbrojtur grupet më të rrezikuara nga vuajtjet në mënyrë shpërpjesëtimore.<sup>62</sup>

Departamenti nuk mban informata të ndara sipas gjinisë lidhur me listën e lejeve ujore të lëshuara kompanive. Gjithashtu, nuk është e qartë nëse shënimet për pasurinë ujore dhe ndëshkimet e lëshuara për ndotje ndahen sipas gjinisë. Gjatë viteve 2014-2016, departamenti dhe divizionet e tij nuk kanë organizuar asnjë seancë publike ose takim konsultativ me qytetarë në lidhje me politikat e reja të propozuara (p.sh. shfrytëzimi i qëndrueshëm i ujit dhe mbrojtja e ujit) ose monitorimin e shfrytëzimit të furnizimit publik me ujë. Siç ka komentuar një përfaqësues i Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore, “natyra e punës dhe përgjegjësisë të këtij sektori nuk e përfshin këtë.”<sup>63</sup>

Megjithatë, duket se hartimi i politikave të reja ujore dhe mbikëqyrja e aktiviteteve publike lidhur me shfrytëzimin e ujit kërkon konsultime dhe / ose aktivitete në terren me gra dhe burra në mënyrë që të diskutohet se si e shfrytëzojnë ujin ata/ato, si dhe për t'i njoftuar më mirë si gratë, ashtu dhe burrat, për rëndësinë e mbrojtjes së ujërave. Nëse kuptohet më mirë se si gratë dhe burrat e shfrytëzojnë ujin, atëherë kjo mund të lehtësojë përgatitjen e politikave më të mira për mbrojtjen e burimeve të çmuara të ujit. Në të njëjtën kohë, konsultimi publik është baza e qeverisjes demokratike të burimeve publike. Siç parashihet ndër të tjera edhe në përgjegjësitë e departamentit, interesi publik mund të mbrohet vetëm kur interesat dhe nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm janë të njohura për zyrtarët të cilët krijojnë dhe zbatojnë politika.

### Objektivat e rekomanduara

1. Të rritet përqindja e burrave që punojnë në Departamentin e Ujërave nga 38% në vitin 2016 në 44% në vitin 2017, duke e ngritur kështu përqindjen e pagave dhe mëditjeve të shpenzuara për burra.
2. Të përmirësohet pasqyrimi i perspektivës gjinore në politikat e reja që kanë të bëjnë me ujërat, duke përfshirë organizimin e më shumë konsultimeve me gra dhe burra lidhur me politikat e reja ujore.
3. Të përmirësohet mbledhja e të dhënave dhe përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë lidhur me kompanitë që marrin leje ujore duke mbajtur informata të ndara sipas gjinisë.
4. Të përmirësohet komunikimi me gra dhe burra përkitazi me shfrytëzimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave.

### Aktivitetet e rekomanduara

1. Në rekrutimin për dy pozitat e hapura në kuadër të departamentit në 2017, të përdoren veprime afirmative me qëllim që të inkurajohen për të aplikuar më shumë burra, dhe po ashtu edhe në kriteret e vlerësimit, në mënyrë që të avancohet më tej baraspesha gjinore në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në këtë departament dhe divizionet e tij, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.
- 2.1. Në krijimin e politikave të reja ujore, të sigurohet organizimi i konsultimeve me gra dhe burra të ndryshëm në mënyrë që të kuptohet më mirë se si i shfrytëzojnë ato/ata burimet ujore. Kjo mund

<sup>62</sup> CAP-NET, GWA 2014. *Why Gender Matters in IWRM: A Tutorial for Water Managers* (Pse është me rëndësi gjinia në MIBU: tutorial për menaxherët e ujit); Dokumenti i plotë burimor, f. 11, marrë nga:

<http://www.thewaterchannel.tv/gender/content/img/frd-full-resource-document-web-version.pdf>.

<sup>63</sup> Korrespondenca e postës elektronike me RrGGK-në, 3 qershor 2016.

të sigurojë informata për politikat dhe planet për shfrytëzim të ujërave që i plotëson nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm. Kjo është pjesë e përgjegjësive ekzistuese të zyrtarëve në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore dhe do të duhej në paraqiste fare pak ose aspak nevojë për burime shtesë (p.sh., për organizimin e takimeve me gra dhe burra). Departamenti po ashtu mund të marrë në konsideratë bashkëpunimin me Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK-në) për të mbledhur informata lidhur me nevojat dhe shfrytëzimin e ndryshëm të ujit nga ngratë dhe burrat përmes anketave me ekonomi familjare, sikurse është anketa “kushtet e jetesës”, e cilat nuk do të paraqiste kosto shtesë.

- 2.2. Gjatë procesit të hartimit të politikave të reja ujore, të sigurohet përfshirja e ZBGj-së dhe konsultimi i ekspertëve gjinor, me qëllim të integritimit të perspektivës gjinore në kuadër të politikave. Kjo është përgjegjësi e zyrtarëve dhe e ZBGj-së, sipas Ligjit për Barazi Gjinore, dhe nuk kërkon kosto shtesë.
3. Të mbahen informata të ndara sipas gjinisë lidhur me listën e lejeve ujore të lëshuara kompanive.
- 4.1. Vlerësimi i mëtejshëm i shfrytëzimit të ujit nga gratë dhe burrat e ndryshëm mund të lehtësojë planifikimin e strategjive për punë në terren dhe komunikim me gra dhe burra, përkatësisht të sigurojë informata për rëndësinë e mbrojtjes së ujërave. Pyetjet lidhur me këtë do të mund të inkorporoheshin në një anketë ekzistuese dhe të rregullt me ekonomi familjare që kryhet nga ana e ASK-së, me fare pak ose asnjë kosto për Ministrinë.
- 4.2. Të sigurohet që në materialet e komunikimit dhe në takime të synohet gratë dhe burrat, duke përfshirë edhe baraspeshën gjinore në ilustrimet që përdoren në materialet e publikuara, për shembull, për mbrojtjen dhe kontaminimin e ujërave. Materialet e tilla mund të informojnë gratë dhe burrat se si ta shfrytëzojnë ujin në mënyrë më efektive në aktivitetet e tyre të përditshme në mënyrë që të zvogëlojnë shfrytëzimin dhe të mbrojnë më mirë këtë burim të kufizuar. Të merret parasysh konsultimi me ZBGj-në dhe organizatat e drejtuara nga gratë për rishikimin e materialeve të komunikimit nga perspektiva gjinore. Nëse në materialet ekzistuese të komunikimit është e përfshirë perspektiva gjinore, nuk do të ketë nevojë për burime shtesë.

## **Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim**

Mënyrat se si burrat dhe gratë i shfrytëzojnë hapësirat publike dhe përvoja e tyre me to mund të ndryshojë. Planifikimi hapësinor që merr parasysh këtë do të sigurojë që nga projektimi, ofrimi, dhe menaxhimi i shërbimeve publike të përfitojnë në mënyrë të barabartë si burrat, ashtu edhe gratë.<sup>64</sup> UN-HABITAT-i ka vërejtur se proceset e planifikimit me një qasje të ndjeshme gjinore ndaj planifikimit hapësinor duhet të adresojnë pyetje të tilla si:

- Cilat janë prioritetet, nevojat dhe rolet e ndryshme të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave, të cilat duhet të adresohen nga planet apo politikat?
- Si do të përfitojnë gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat, nga planet apo politikat?
- Si do të zbatohen, monitorohen dhe menaxhohen planet apo politikat?<sup>65</sup>

Për tu përgjigjur në këto pyetje, qytetarët e ndryshëm duhet të ftohen në konsultime publike, të informohen, dhe të kenë qasje në dokumentet e planifikimit. Nevojat e tyre duhet të vlerësohen, duke përfshirë edhe mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë.

Në kuadër të MMPH-së, Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim monitoron, analizon, projektin dhe propozon strategji dhe programe, si dhe ndërmerr masa lidhur me planifikimin hapësinor, ndërtimin dhe banimin. Ai gjithashtu monitoron zbatimin e politikave të MMPH-

---

<sup>64</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat), *Integrimi gjinor në planifikimin hapësinor: një qasje hap pas hapi për komuna*, Prishtinë: 2014, f. 12, marrë nga: [http://home.fa.utl.pt/~camarinhas/Gender\\_Mainstreaming\\_in\\_SP.pdf](http://home.fa.utl.pt/~camarinhas/Gender_Mainstreaming_in_SP.pdf).

<sup>65</sup> Po aty.

së që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor, ndërtimin dhe banimin.<sup>66</sup> Ky departament ka tri divizione: Divizionin për Planifikim Hapësinor, Divizionin për Ndërtim, dhe Divizionin për Banim.

Ky departament ka planifikuar një ulje të konsiderueshme të buxhetit të tij për vitin 2017, duke përfshirë edhe uljen në të gjitha kategoritë ekonomike, por në veçanti në investime kapitale.<sup>67</sup> Informata të tjera lidhur me divizionet individuale të këtij departamenti vijnë më poshtë.

Siç ilustron tabelën 12, ky departament në bashkëpunim me akterë të tjerë, lokalë dhe ndërkombëtarë, ka ofruar 14 trajnime në periudhën 2014-2016. Në total, gratë përbëjnë 75% të përfituesve ndërsa burrat 25%. Ky departament mund të ndërmerr hapa për të siguruar një baraspeshë më të mirë në trajnimet e ardhshme.

<b>Trajnimi</b>	<b>Organizatori</b>	<b>Totali</b>	<b># dhe % e grave</b>	<b># dhe % e burrave</b>
Eficienca energjetike në ndërtesa	MMPH/Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)	12	7 (58%)	5 (42%)
Zhvillimi i politikave publike dhe lidhshme	USAID	5	2 (40%)	3 (60%)
Programi për Trajnim të Trajnuesve: Pjesëmarrja e publikut në planifikim hapësinor; hartimi i planeve për zhvillim komunal	UN-HABITAT	1	0 (0%)	1 (100%)
Mbledhja e të dhënave, ortofotot & interpretimi i imazheve satelitore	UN-HABITAT	2	2 (100%)	0 (0%)
Hartimi i vlerësimeve mjedisore strategjike	UN-HABITAT	5	4 (80%)	1 (20%)
Pjesëmarrja e publikut në planifikim hapësinor	UN-HABITAT	2	2 (100%)	0 (0%)
Trajnime bazik në ArcGIS, gjinia dhe të drejtat pronësore në Kosovë	UN-HABITAT	2	2 (100%)	0 (0%)
Hartimi i planeve zhvillimore komunale	UN-HABITAT	5	4 (80%)	1 (20%)
Korniza e përbashkët e vetë-vlerësimit	Ministria e Administratës Publike (MAP), Instituti i Kosovës për Administratë Publike	1	1 (100%)	0 (0%)
Shkolla për planifikim hapësinor dhe zhvillim urban	<i>Ec ma Ndryshe</i>	2	2 (100%)	0 (0%)
SPAK Punëtorja për Trajnimin e Trajnerëve	Projekti i BE-së për implementimin dhe zbatimin e planifikimit hapësinor rural	4	4 (100%)	0 (0%)
Trajnime për përdorimin e Q GIS	Projekti i BE-së për implementimin dhe zbatimin e planifikimit hapësinor rural	6	5 (83%)	1 (17%)
Ngritja e kapaciteteve për hartën e zonimit të Kosovës dhe hartën e zonimit komunal	Projekti për Partneritetin për Zhvillim i USAID-it	5	4 (80%)	1 (20%)
Tryeza e rrumbullakët për Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe hartën e zonimit komunal	Projekti për Partneritetin për Zhvillim i USAID-it	5	4 (80%)	1 (20%)
<b>Gjithsej</b>		<b>57</b>	<b>43 (75%)</b>	<b>14 (25%)</b>

<sup>66</sup> Faqja e internetit e MMPH-së, marrë nga: <http://mmp-h-rks.org/sq/Departamenti-i-Planifikimit-Hapesinor,Ndertimit-dhe-Banimit->

<sup>67</sup> Kjo mund të ketë ndodhur për shkak se investimet kapitale nuk ishin reflektuar plotësisht në draftin e partë të buxhetit për vitin 2017 në kuadër të tabelave të buxhetit të secilit departament, divizion, ose sektor (megjithëse ato gjendeshin aty në total).

## Pagat dhe mëditjet

Edhe pse Ligji për Buxhetin e vitit 2016 parashikonte se departamenti dhe divizionet e tij do të kishin 19 punonjës, departamenti ka pasur vetëm 17 punonjës që prej gushtit të vitit 2016. Në draft-buxhetin e vitit 2017 parashikohen 19 punonjës, por buxheti i kërkuar për pagat dhe mëditjet është rritur me 7,365 euro, kështu që çdo punonjës i punësuar do të jetë ndoshta në nivelin e pagës më të ulët. Aktualisht, baraspesha gjinore në radhët e punonjësve brenda këtij departamenti dhe divizioneve të tij është mjaft e baraspeshuar, ku burrat përbëjnë 41% të punonjësve dhe gratë 59% të tyre. Përafërsisht 43% e kategorisë ekonomike të pagave dhe mëditjeve janë shpenzuar për burrat dhe 57% për gratë.

Niveli i pagës	Numri i përgjithshëm i personelit në çdo nivel page	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma e përgjithshme e shpenzuar
201-400	1	0 (0%)	€0 (0%)	1 (100%)	€3,856 (100%)	€3,856
401-600	15	6 (40%)	€34,292 (40%)	9 (60%)	€51,395 (60%)	€85,687
600+	1	1 (100%)	€7,353 (100%)	0 (0%)	€0 (0%)	€7,353
<b>Gjithsej</b>	<b>17</b>	<b>7 (41%)</b>	<b>€41,645 (43%)</b>	<b>10 (59%)</b>	<b>€55,252 (57%)</b>	<b>€96,897</b>

## Investimet kapitale

Në tabelën 14 paraqiten investimet kapitale të planifikuara nga ky departament për vitin 2017. Pavarësisht kërkesave, nuk janë ofruar të dhëna lidhur me konsultimet publike të zhvilluara me gratë dhe burrat, për t'i identifikuar këto si investime kapitale me prioritet. Nuk janë ofruar informata as lidhur me numrin dhe përqindjen e pritshme të grave dhe burrave që do të përfitojnë nga investimet. Nga perspektiva e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, priorizimi, planifikimi, zbatimi dhe përdorimi i të gjitha projekteve të shpenzimeve kapitale duhet të përfshijnë mbajtjen e konsultimeve me gratë dhe burrat lidhur me prioritetet e tyre.<sup>69</sup> Konsultimet me gratë dhe burrat janë të rëndësishme për të siguruar që këto shpenzime publike të priorizohen si nga gratë, ashtu edhe nga burrat, si dhe të planifikohen në mënyrë që të përfitojnë si gratë, ashtu edhe burrat.

Investime	Bashkë-financim i MMPH-së për komunat, për vitin 2017	Të ardhurat nga burimet e veta, për vitin 2017	Gjithsej për vitin 2017	Parashikuar për vitin 2018	Parashikuar për vitin 2019	Gjithsej për periudhën 2017-2019	Financim jashtëm
Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive të personave të kthyer	€713,500	€0	€713,500	€1,000,000	€1,000,000	€2,713,500	€0
Ndërtimi i përkujtimitores "Baza e Parë e UÇK-së", Lladrovç, Podujevë	€214,000	€0	€214,000	€0	€0	€214,000	€0
Krijimi i bazës së të	€20,000	€0	€20,000	€20,000	€20,000	€60,000	€0

<sup>68</sup> Të dhënat janë siguruar nga Divizioni i Personelit, në baza mujore. Llogaritjet e pagave vjetore dhe rrumbullakimi i numrave është bërë nga RrGGK-ja.

<sup>69</sup> Për hollësi për atë se me çfarë ka të bëjë kjo dhe për udhëzime, duke përfshirë edhe mostrat për tabelat që mund të përdoren në planifikimin e shpenzimeve kapitale, ju lutemi të shihni: RrGGK, *Udhërrëfyes Praktik: Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor në Nivelin Qendror*, Prishtinë: 2014, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/2014/1128100658900.pdf>.

dhënave për menaxhim të kërkesave për banim							
Plani rregullues dhe ndërtimi i zonës së veçantë dhe të mbrojtur të rezistencës	€30,000	€0	€30,000	€30,000	€30,000	€90,000	€0
Ndërtimi i përkujtimores "Agim Zhitia", Lluga, Podujevë	€200,000	€0	€200,000	€157,759	€0	€357,759	€0
<b>Gjithsej</b>	<b>€1,177,500</b>	<b>€0</b>	<b>€1,177,500</b>	<b>€1,050,000</b>	<b>€1,050,000</b>	<b>€3,435,259</b>	<b>€0</b>

## Divizioni për Planifikim Hapësinor

Divizioni për Planifikim Hapësinor prezanton dhe siguron zbatimin e politikave që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor. Ai përgatit rregullisht raporte lidhur me planifikimin hapësinor dhe vlerëson ligjshmërinë e akteve të nivelit lokal lidhur me planifikimin urban dhe rural.<sup>70</sup> MMPH ka përgatitur një doracak për integrimin e çështjeve gjinore në procesin e rregullimit të zgjidhjeve joformale, të hartuara me përkrahjen e Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë. Duke e përdorur këtë doracak, MMPH-ja ka organizuar edhe një takim me tryezë të rrumbullakët në vitin 2014 për të udhëzuar zyrtarët komunalë dhe planifikuesit hapësinorë lidhur me përfshirjen e perspektivës gjinore në procesin e rregullimit të udhëve joformale, duke u mbështetur në praktikën e mira që aplikohen diku tjetër në botë. Gjithsej kanë marrë pjesë 74 zyrtarë komunalë, ku 30% ishin gra. Edhe pse ky doracak përmban një perspektivë gjinore që bie në sy, jo të gjitha politikat e propozuara i janë nënshtruar analizës gjinore.

Sipas Ligjit për Barazi Gjinore, të gjitha politikat duhet të përfshijnë analizën gjinore dhe një perspektivë gjinore. Për shembull, planifikimi hapësinor duhet t'i kushtojë vëmendje nevojave dhe aftësive potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave të moshave. Për të siguruar që politikat plotësojnë nevojën të ndryshme, është thelbësore të organizohen konsultime me publikun lidhur me politikat e nivelit lokal dhe qendror, duke përfshirë masa specifike për të siguruar praninë e grave dhe burrave të ndryshëm në këto takime. Kështu, takimet konsultative duhet të reklamohen mirë dhe të zhvillohen në një vend dhe kohë ku mund të marrin pjesë gra dhe burra të ndryshëm. Divizioni mund të bashkëpunojë për së afërmi me Institutin për Planifikim Hapësinor për t'u mbështetur në informatat e mbledhura gjatë konsultimeve të organizuara nga Instituti, duke siguruar marrjen parasysh të nevojave të grave dhe burrave.

## Divizioni i Ndërtimit

Divizioni i Ndërtimit prezanton dhe siguron zbatimin e politikave që kanë të bëjnë me ndërtimin. Në të ardhmen, ai duhet të monitorojë proceset e licencimit të profesionistëve që punojnë në sektorin e ndërtimit dhe t'i koordinojë veprimtaritë e tyre. Ky divizion jep këshilla dhe udhëzime për odat profesionale, ku anëtarët duhet patjetër të japin Provimin Profesional dhe Provimin për Licencim. Ai bashkëpunon me organizata ndërkombëtare dhe me agjenci të specializuara për të këmbyer përvoja lidhur me fushën e ndërtimit.<sup>71</sup>

Sipas Ligjit për Barazi Gjinore, të gjitha politikat duhet të mbështeten në analizën gjinore dhe të përfshijnë një perspektivë gjinore. Deri më sot, duket se strategjitë dhe programet në fushën e

<sup>70</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 13.

<sup>71</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 14.



ndërtimit nuk e kanë përfshirë analizën gjinore. Kjo ndoshta do të thotë se nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave nuk merren parasysh mjaftueshëm.

Ministria planifikon të licencojë profesionistë në fushën e ndërtimit përmes një ligji të veçantë, i cili është ende në proces hartimi. Për këtë arsye, divizioni nuk ka nisur ende licencimin e profesionistëve të fushës së ndërtimit.<sup>72</sup> Baza e të dhënave me emrat e profesionistëve të licencuar duhet të përmbajë të dhëna të ndara sipas gjinisë.

## Divizioni i Banimit

Divizioni i Banimit harton dhe siguron zbatimin e politikave që kanë të bëjnë me banimin. Ai i përkrah komunat në zbatimin e përgjegjësive të tyre ligjore. Krahas kësaj, ky divizion iu ofron përkrahje institucioneve private dhe publike përmes investimeve dhe projekteve të zhvillimit, të cilat kanë të bëjnë me banimin në Kosovë.<sup>73</sup> Divizioni ka një program për rinovimin dhe ndërtimin e shtëpive për personat e kthyer në periudhën 2014-2016, të financuar nga buxheti i Kosovës.

Në vitin 2015, 16,546 persona janë kthyer nga vende të ndryshme në Kosovë, nga të cilët 54.6% me detyrim dhe 45.3% vullnetarisht.<sup>74</sup> Nga personat e kthyer me detyrim, 29% ishin gra dhe 71% burra. Nga personat e kthyer me dëshirë, 23.8% ishin gra dhe 76.2% burra. Nga janari deri në qershor të vitit 2016, janë riatdhesuar 3,897 persona, nga të cilët 87% me detyrim.<sup>75</sup> Nga personat e kthyer me detyrim, 32,8% ishin gra dhe 67,2% burra. Nga personat e kthyer me dëshirë, 43% ishin gra dhe 57% burra. Kjo lë të kuptohet se ka një trend sipas të cilit numri i burrave të kthyer është më i madh sesa ai i grave të rikthyera, ndoshta për shkak se numri i burrave që kanë emigruar ka qenë më i madh sesa ai i grave, edhe pse kjo është e vështirë të gjurmohet. Informatat lidhur me përqindjen e personave që kthehen dhe të cilët kanë banesë në të cilën mund të kthehen, të ndara sipas gjinisë, nuk ishin të disponueshme. Këto informata mund të jenë të dobishme për identifikimin e nivelit të nevojave, duke përfshirë ato të grave dhe burrave.

Në vitin 2016, fondi për banim për personat e kthyer ishte 471,200 euro.<sup>76</sup> Sikurse ilustron tabelën 16, 92.2% e shtëpive të rindërtuara dhe 95% e shtëpive të rinovuara, drejtohen nga burra. Në këtë mënyrë, familjet e drejtuara nga burrat kanë marrë pjesën dërmuese të financimit. Kjo nuk është e befasishme, pasi në Kosovë, familjet kanë prirje të përcaktohen se udhëhiqen nga burra. Megjithatë, pa ditur përfituesit e përgjithshëm *brenda ekonomisë familjare* sipas gjinisë ose pa një analizë gjinore të nivelit të nevojës (p.sh. sa të kthyer kishin shtëpi, sipas gjinisë), është e vështirë të vlerësohet shkalla në të cilën ky program iu përgjigjet nevojave të grave dhe burrave. Për të analizuar shpenzimet për rindërtimin dhe/ose rinovimin e banesave, nevojiten më shumë të dhëna të ndara sipas gjinisë. Të dhënat e tjera lidhur me mënyrën se si merren parasysh nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave në rindërtimin e banesave, nuk ishin të disponueshme.

Tabela 15. Shtëpitë e rindërtuara apo rinovuara për personat e rikthyer, 2014-2016			
	Familjet që drejtohen nga burra	Familjet që drejtohen nga gra	Gjithsej
Rindërtim	65 (92,2%)	4 (5.8%)	69
Rinovim	57 (95%)	3 (5%)	60

<sup>72</sup> Letërkëmbim elektronik me një përfaqësues të divizionit, 20 maj 2016.

<sup>73</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 15.

<sup>74</sup> Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Punëve të Jashtme, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, *Raporti Statistikor Vjetor 2015*, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion [DSHAM] / Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), marrë nga: [http://mpbks.org/repository/docs/WEB\\_Raport\\_2015\\_Shqip.pdf](http://mpbks.org/repository/docs/WEB_Raport_2015_Shqip.pdf).

<sup>75</sup> Llogaritjet janë bërë nga RrGGK-ja, duke u mbështetur në: Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, *Raporti Statistikor K1, 2016 DSHAM* / MPJ, marrë nga: [http://mpb-ks.org/repository/docs/TMI - SHQIP 2016\\_web.pdf](http://mpb-ks.org/repository/docs/TMI - SHQIP 2016_web.pdf), dhe *Raporti Statistikor K2, 2016 DSHAM* / MPJ, marrë nga: [http://mpb-ks.org/repository/docs/Rap\\_K2\\_2016\\_Alb\\_web.pdf](http://mpb-ks.org/repository/docs/Rap_K2_2016_Alb_web.pdf).

<sup>76</sup> Letërkëmbim elektronik me udhëheqësin e divizionit, 30 maj 2016. Buxheti ishte nën buxhetin e Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim që prej vitit 2015.



Sipas udhëheqësit të departamentit, në vitet 2017 dhe 2018, projekti do të vazhdojë me përkrahjen e donatorëve që vlerësohet në shumën 9.5 milionë euro. Departamenti duhet të sigurojë që këto para të shpenzohen në mënyrë të përgjegjshme përmes kryerjes së një analize gjinore të nevojave dhe shpenzimeve të ndryshme, sipas rrethanave.

### Objektivat e rekomanduara

1. Të garantohet përmirësimi i baraspeshës gjinore midis pjesëmarrësve në trajnimet e ardhshme.
2. Të të rritet lehtë përqindja e burrave të punësuar nga 41% në vitin 2016 në 47% në vitin 2018, në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të baraspeshës gjinore brenda këtij departamenti dhe divizioneve të tij, si dhe me qëllim të arritjes së shpenzimit më të barabartë të pagave dhe mëditjeve për gratë dhe burrat.
3. Të përmirësohen procedurat për prioritizimin, planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e përdorimit të projekteve me shpenzime kapitale, nga një perspektivë gjinore, duke përdorur praktikatat më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinore.
4. Të tregohet kujdes që gratë dhe burrat të marrin pjesë në konsultime publike të organizuara për prioritizimin, planifikimin dhe zbatimin e projekteve të investimeve kapitale.
5. Të tregohet kujdes që baza e të dhënave për menaxhimin e kërkesave për strehim të përfshijë të dhëna të ndara sipas gjinisë, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore (të detajuar më poshtë).
6. Të përmirësohet sistemi për gjurmimin e shpenzimeve publike për përkujtimoret.
7. Të tregohet kujdes që të gjitha politikatat dhe strategjitë e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit të mbështeten në të dhëna të nxjerra nga analiza gjinore dhe të përfshijnë një perspektivë gjinore.

### Aktivitetet e rekomanduara

1. Të gjurmohen, përmes një baze të vogël të të dhënave, personat që marrin pjesë në trajnime sipas gjinisë. Kur ka mundësi për trajnime, të bëhen përpjekje për të siguruar baraspeshë të grave dhe burrave që marrin pjesë, pavarësisht temës.
2. Të përdoren masa informative për të inkurajuar më shumë burra që të aplikojnë për dy pozitat e lira, si dhe në vlerësimin e kandidatëve, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore.
3. Të krijohet një bazë e thjeshtë e të dhënave në Microsoft Excel duke përdorur shabllonet që paraqiten në punimin e RrGGK-së të titulluar *Udhërrëfyes Praktik: Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor në Nivelin Qendror*. Të përdoren këto shabllone në identifikimin, planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e përdorimit të të gjitha shpenzimeve kapitale, të përkrahura nga departamenti. Kjo do të ndihmojë për të vlerësuar, si dhe për të ofruar dëshmi më të mira, lidhur me atë nëse me gratë dhe burrat e komuniteteve të synuara janë zhvilluar këshillime të mjaftueshme. Këshillimet publike cilësore ofrojnë një justifikim më të mirë për shpenzimet publike, si dhe kontribuojnë në dizajnimin më të mirë të investimeve. Këto shabllone i mundësojnë Departamentit të identifikojnë: nëse shpenzimet e planifikuara përbëjnë prioritet për komunitetin (p.sh. krahasuar me shpenzimet e tjera të mundshme në aspektin e planifikimit hapësinor); si duhet të dizajnohet investimi, duke përfshirë arkitekturën dhe tiparet, me qëllim që të maksimizohet përdorueshmëria e tij nga ana e grave dhe burrave të ndryshme; shkalla në të cilën janë përfshirë gratë dhe burrat në ndërtimin real (p.sh. të punësuar përmes shpenzimeve publike), gjë e cila mund të inkurajohet në proceset e prokurimit, përmes përdorimit të veprimeve afirmative, të parashikuara me Ligjin për Barazi Gjinore; si dhe shkallën në të cilën gratë dhe burrat e përdorin investimin pas ndërtimit të tij. Kjo e fundit mund të ofrojë të dhëna lidhur me prioritizimin e investimeve të ngjashme në të ardhmen për sa i takon përdorimit të mundshëm më vonë. Të dhënat mund të mirëmbahen me lehtësi nga personeli aktual i departamentit dhe divizioneve të tij, si pjesë e detyrimit të tyre ligjor për të mbajtur të dhëna të ndara sipas gjinisë, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Për këtë arsye, mirëmbajtja e këtyre të dhënave nuk do t'i shkaktojë kosto shtesë departamentit, por do të kontribuojë në përmirësimin e informimit mbi të cilin mbështeten projektet e investimeve kapitale, si dhe në evidentimin më të mirë të kërkesave për financimin e tyre.

4. Të bashkëpunohet me Institutin për Planifikim Hapësinor, me komunat e synuara, dhe me organizatat lokale që drejtohen nga gra, për të organizuar konsultime publike të mirë-reklamuar me gra dhe burra të ndryshëm, për të siguruar që nevojat dhe interesat e tyre potencialisht të ndryshme lidhur me planifikimin hapësinor dhe projektet specifike të investimeve kapitale të merren parasysh. Nëse këto konsultime zhvillohen në ndërtesa publike, buxheti i kërkuar do të jetë i vogël ose nuk do të kërkohej buxhet shtesë fare. Megjithatë, takimet do të kontribuonin thelbësisht në dizajnimin e politikave të përmirësuara që i përmbushin nevojat e grave dhe burrave në planifikimin hapësinor. Për shembull, me rastin e bërjes së kërkesave më bindëse për shpenzime kapitale, siç janë ndërtimi dhe rinovimi i shtëpive të personave të kthyer, kërkesat duhet të përfshijnë numrin e pritshëm të grave dhe burrave të cilët do të përfitojnë nga këto shpenzime publike. Duhet të identifikohen aktivitetet për këshillimet me gra dhe burra gjatë procesit të ndërtimit dhe renovimit, me qëllim që të sigurohet që ofrimi i banesave të përmbushë nevojat e grave dhe burrave në aspektin e dizajnit arkitekturor.
5. Të tregohet kujdes që termat e referencës për bazën e të dhënave për menaxhimin e kërkesave për banim, të përfshijnë të dhëna të ndara sipas gjinisë, lidhur me atë se kush e ka bërë kërkesën, kush do ta përdorë banesën, dhe nëse personi që kërkon përdorimin e banesës vjen nga ndonjë grup i cenushtëm, duke përfshirë edhe personat që kanë vuajtur nga dhuna me bazë gjinore. Duke marrë parasysh qëllimet e qeverisë për të ofruar banesa publike për personat të cilët kanë vuajtur nga dhuna me bazë gjinore, duke përfshirë edhe dhunën në familje,<sup>77</sup> baza e të dhënave teorikisht duhet të përmbajë të dhëna konfidenciale lidhur me faktin nëse personi apo personat që kërkojnë banesë vijnë nga një grup në nevojë, të cilit qeveria i ka dhënë përparësi lidhur me përdorimin e banesave publike.
6. Të krijohet një bazë e thjeshtë e të dhënave në Microsoft Excel për gjurmimin e ndërtimit të përkujtimeve të financuara me fonde publike, duke përfshirë: emrin e përmendores, vendin ku ndodhet, numrin e grave dhe burrave të konsultuar në kuadrin e prioritizimit të ndërtimit të saj ndaj projekteve të tjera të mundshme ndërtimore publike, numrin e grave dhe burrave të këshilluar lidhur me modelimin e saj, datën e ndërtimit, kostot e ndërtimit, si dhe numrit e grave dhe burrave që e përdorin atë në vitin e parë pas ndërtimit. Mirëmbajtja e këtyre të dhënave mund të ofrojë informata më të mira mbi të cilat mund të mbështetet planifikimi i përmendoreve në të ardhmen, duke përfshirë përligjen e tyre në kërkesat për buxhet. Kjo mund të kryhet lehtësisht, pa kosto, dhe të mirëmbahet nga punonjësit ekzistues në harmoni me përgjegjësit për mbajtjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Pra për departamentin nuk do të ketë kosto shtesë, por do të lehtësohet ofrimi i informatave më të mira ku do të mbështetet planifikimi i buxhetit në të ardhmen. Grupet e shoqërisë civile kanë ngritur shqetësimin se përqindja e përmendoreve që përqendrohen në kontributet që kanë dhënë gratë për Kosovën është e pamjaftueshme.<sup>78</sup>
7. Të ndërmerret një analizë gjinore për të krijuar të dhëna ku të mbështetet hartimi i politikave dhe programeve lidhur me planifikimin hapësinor dhe ndërtimin. Kjo mund të sigurojë që nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave të merren parasysh në kuadrin planifikimit hapësinor dhe punët ndërtimore. ZBGJ-ja, ekspertët për barazi gjinore dhe përfaqësuesit e organizatave që drejtohen nga gra mund të ftohen të marrin pjesë në grupet punuese që hartojnë politikat, me qëllim që t'i shqyrtojnë këto nga pikëpamja gjinore dhe të përkrahin integrimin e çështjeve gjinore brenda kuadrin të këtyre politikave. Për MMPH-në do të ketë pak ose aspak kosto shtesë.

<sup>77</sup> Shih, për shembull, Qeveria e Kosovës, *Programi Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimet 2011 – 2014*, Prishtinë: 2011, marrë nga: <http://abgj.rks.gov.net/Portals/0/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20Kund%C3%ABr%20Dhun%C3%ABs%20n%C3%AB%20Familje%20dhe%20Plani%20i%20veprimet.pdf>.

<sup>78</sup> Për komente të mëtejshme lidhur me çështjet gjinore dhe përmendoret në Kosovë, shihni: Eli Krasniqi, *Memorials in Kosovo Today* [Përmendoret në Kosovë Sot], marrë nga: [http://www.academia.edu/2627127/Memorials\\_in\\_Kosovo\\_Today](http://www.academia.edu/2627127/Memorials_in_Kosovo_Today).

## Departamenti i Shpronësimit

Departamenti i Shpronësimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi, pranon dhe menaxhon aplikacione për shpronësim, propozon draft-vendimet përkatëse dhe ofron kompensim për pasuritë e shpronësuara.<sup>79</sup> Ky departament përbëhet nga dy divizione: Divizioni për Çështje Pronësore<sup>80</sup> dhe Divizioni Tekniko-Financiar.<sup>81</sup> Departamenti ka planifikuar që shuma e buxhetuar për pjesën më të madhe të kategorive ekonomike të mbetet e njëjtë në vitin 2017. Buxheti i përgjithshëm duket se është zvogëluar, por kjo ka të ngjarë të vijë si rezultat i faktit se investimet kapitale nuk janë reflektuar plotësisht në draft-buxhetin e parë të vitit 2017 brenda tabelave individuale të buxhetit të secilit departament, divizion apo sektor.

### Pagat dhe mëditjet

Departamenti ka gjashtë punonjës në vitin 2016, edhe pse fillimisht, në buxhet, ishin parashikuar shtatë. Ka një ndarje të barabartë të grave dhe burrave që punojnë për departamentin, edhe pse burrat marrin pak më shumë shpenzime nga kategoria e pagave dhe mëditjeve (55%) për shkak të pozitës që kanë në departament.

**Tabela 16. Punonjësit e Departamentit për Shpronësim sipas gjinisë dhe nivelit të pagës në periudhën jan. - gusht 2016**<sup>82</sup>

Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201-400	1			1 (100%)	€3,856 (100%)	€3,856
401-600	4	2 (50%)	€11,874 (50%)	2 (50%)	€11,895 (50%)	€23,769
600+	1	1 (100%)	€7,353 (100%)			€7,353
<b>Gjithsej</b>	<b>6</b>	<b>3 (50%)</b>	<b>€19,227 (55%)</b>	<b>3 (50%)</b>	<b>€15,752 (45%)</b>	<b>€34,979</b>

### Programet dhe aktivitetet

Shpronësimi i pronave ka filluar në vitin 2010, kur u ndërtua autostrada "Vermicë-Merdare". Deri më sot, Qeveria e Kosovës ka miratuar 62 vendime përfundimtare për shpronësimin dhe është bërë shpronësimi i 10,000 pronave.<sup>83</sup> Në tabelën 17 tregohen llojet e ndryshme të pronave të shpronësuara gjatë periudhës 2010–2016. Të dhënat nuk janë ndarë sipas gjinisë.

**Tabela 17. Pronat e shpronësuara, 2010-2016**

Prona private	70.15%
Prona komunale	5.64%
Prona publike	4.80%
Prona shoqërore	19.41%

Në tabelën 18 paraqitet përmbledhtazi numri i ankesave, kërkesave dhe kërkesave për informata, dhe njoftimeve nga vitit 2012 deri në vitin 2015, të ndara sipas gjinisë. Çdo vit, burrat kishin prirje të parashtronin pjesën dërrmuese të këtyre. Kjo mund të lidhet me faktin se gratë përbëjnë

<sup>79</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 24.

<sup>80</sup> Divizioni për Çështje Pronësore pranon aplikime për shpronësim në pajtim me legjislacionin në fuqi, organizon seanca dëgjimore publike lidhur me kërkesat për shpronësim, sipas vendimeve të qeverisë, dhe jep këshilla lidhur me procesin e shpronësimit. Ai shqyrton ankesa të pranuar nga Komisioni dhe Departamenti, lidhur me shpronësimin dhe lëvizjen e banorëve (Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 25)

<sup>81</sup> Divizioni Tekniko-Financiar pranon dhe trajton dokumentacionin për kompensim dhe përgatit dokumentacionin e nevojshëm për ekzekutim të pagesave. Bashkëpunon me palët e interesit dhe ofron përkrahje për organizimin e seancave dëgjimore publike për kërkesat e pranuar për shpronësim (po aty, neni 26).

<sup>82</sup> Të dhënat janë siguruar nga Divizioni i Personelit, në baza mujore. Llogaritjet e pagave vjetore dhe rumbullakimi i numrave është bërë nga RrGGK.

<sup>83</sup> Të dhëna nga korrespondenca elektronike me RrGGK-në, 2 qershor 2016.

vetëm 15.3% të pronarëve individualë apo aksionarë të pronave në Kosovë.<sup>84</sup> Prandaj, gjasat që gratë të parashtrajnë korrespondenca lidhur me pronën janë më të vogla sesa ato për burrat. Divizioni, me anë të hulumtimit të mëtejshëm cilësor, mund të shqyrtojë shkaqet pse gratë nuk prirën të parashtrajnë korrespondenca me departamentin.

Tabela 18. Ankesat, kërkesat, kërkesat për informata dhe njoftimet për periudhën 201-2015					
Viti		Lloji			
		Kërkesa	Ankesa	Njoftime	Kërkesa për informata
2012	Gra	0	0	0	0
	Burra	7	0	1	0
	<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>
2013	Gra	1	0	0	0
	Burra	18	0	0	1
	<b>Gjithsej</b>	<b>19</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>
2014	Gra	0	0	0	0
	Burra	18	4	0	2
	<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>2</b>
2015	Gra	11	0	0	0
	Burra	196	17	0	0
	<b>Gjithsej</b>	<b>207</b>	<b>17</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

#### Objektivat e rekomanduara

1. Të rriten shpenzimet për gratë nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve nga 45% në vitin 2016.
2. Të tregohet kujdes që të dhënat që kanë të bëjnë me shpronësimet të ndahen sipas gjinisë, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore.

#### Aktivitetet e rekomanduara

1. Duke marrë parasysh që buxheti parashikon punësimin e një anëtarit tjetër të personelit, të përdoret një veprim afirmativ për t'i nxitur gratë të aplikojnë, si dhe për t'u dhënë pikë shtesë kandidateve (gra) gjatë procesit të marrjes në punë, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Edhe pse ekziston një baraspeshë midis grave dhe burrave, meqenëse burrat aktualisht marrin disi më shumë prej këtyre shpenzimeve, punësimi i një gruaje si punonjëse e shtatë do të mund të kontribuonte në baraspeshimin e mëtejshëm të shpenzimeve nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, midis grave dhe burrave.
2. Të ndahen sipas gjinisë shpronësimet e bëra, duke përfshirë shumën e kompensimit që është ofruar dhe madhësinë e pronës së shpronësuar. Teorikisht, të dhënat duhet të mblidhen lidhur me gjininë e anëtarëve të familjes brenda familjeve të prekura. Kjo nuk do të ketë kosto shtesë për departamentin.
3. Në kërkesat për shpronësime, të tregohet kujdes që emri i gruas dhe i burrit të jenë në formular, me qëllim që të sigurohet që si gratë, ashtu edhe burrat, të jenë të informuar lidhur me procedurën e shpronësimit dhe shumat e kompensimit. Kjo nuk do të ketë kosto shtesë për Ministrinë, por mund të kontribuonte në çuarjen më tej të barazisë gjinore në Kosovë, duke mbrojtur të drejtat e grave për t'u informuar rreth vendimeve të marra lidhur me pronën e tyre.
4. Në zonat e prekura nga shpronësimi, të bëhet përfshirja aktive e grupeve të grave dhe organizatave jo-qeveritare në funksion të mbështetjes së organizimit të konsultimeve publike dhe shpërndarjes së informatave lidhur me të drejtat që kanë gratë dhe burrat në shpronësim. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që gratë dhe burrat të jenë të informuar për të drejtat e tyre, me

<sup>84</sup> Republika e Kosovës, Qeveria, MMPH, faqja e internetit e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, marrë nga: <http://akk-statistics.rks-gov.net/>, përditësuar më 11 gusht të vitit 2016.

qëllim që të shmanget diskriminimi potencial ndaj grave brenda familjeve, për sa i takon pranimit të këtyre fondeve. Ministria nuk do të ketë kosto shtesë për ta bërë këtë.

5. Të përfshihet në formularët për regjistrimin e ankesave, kërkesa, kërkesa për informata dhe njoftime një pyetje lidhur me shkaqet për të cilat ai person, e jo një anëtar tjetër i familjes, e parashtron ankesën, si për shembull: "bashkëshortja nuk kishte mundësi; prona është nën emrin tim; në shtëpi merrem unë me këto gjëra, e bashkëshortja; dhe shkaqe të tjera (për t'u shënuar)." Kjo mund të ndihmojnë në mbledhjen e informatave lidhur me shkaqet për të cilat burrat kanë prirje të parashtrorjës korrespondenca më shpesh sesa gratë. As kjo nuk do të kërkojë financime shtesë nga Ministria, edhe pse do të duhej të caktohej kohë për burimet njerëzore që të kryenin analizën e informatave të mbledhura. Kjo do të jetë në harmoni me Ligjin për Barazi Gjinore, i cili kërkon që të gjitha institucionet të mbajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë.

## Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit

Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit koordinon inspektimet në pajtim me planin vjetor të inspektoratit për secilën fushë dhe me ligjet në fuqi.<sup>85</sup> Gjithashtu, ai merr pjesë në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e mjedisit, pranon ankesa nga shoqatat dhe qytetarët, dhe i shqyrton këto në pajtim me ligjet në fuqi. Departamenti ka dy divizione: Divizioni për Inspektim të Mbrojtjes së Mjedisit, Natyrës dhe Ujërave, dhe Divizioni për Inspektim të Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtim. Departamenti ka pasur shpenzime përkatësisht vetëm lidhur me pagat dhe mëditjet, dhe mallrat dhe shërbimet. Planifikohet që këto të mbeten pak a shumë njëjloj edhe në vitin 2017.

### Pagat dhe mëditjet

Edhe pse buxheti i vitit 2016 parashikonte 29 punonjës, duke filluar nga gushti i vitit 2016, departamenti dhe divizionet e tij kanë pasur 28 anëtarë personeli, nga ku 29% ishin gra. Përafërsisht 29% e kategorisë ekonomike të pagave dhe mëditjeve janë shpenzuar për gratë dhe 71% për burrat.

Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201-400	1	0 (0%)	€0 (0%)	1 (100%)	€4,543 (100%)	€4,543
401-600	26	19 (73%)	€105,274 (71%)	7 (27%)	€42,267 (29%)	€147,541
600+	1	1 (100%)	€7,353 (100%)	0 (0%)	€0 (0%)	€7,353
<b>Gjithsej</b>	<b>28</b>	<b>20 (71%)</b>	<b>€112,627 (71%)</b>	<b>8 (29%)</b>	<b>€46,810 (29%)</b>	<b>€159,436</b>

Ky departament nuk ka ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë lidhur me aktivitetet e tij. Në rastin më të mirë, departamenti duhet të mbajë një listë të vendeve të inspektuara, duke ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë aty ku është e mundur, për shembull nëse kompanitë e përfshira drejtohen nga gra apo burra, si dhe të dhëna lidhur me përbërjen e komuniteteve të prekura, sipas gjinisë.

<sup>85</sup> Në buxhet dhe rregullore, ky organ quhet "departament". Megjithatë, udhëheqësi i divizionit me të njëjtin emër, iu referua si "inspektorat". Shihni: Rregulloren e QRK-së, Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 21.

<sup>86</sup> Të dhënat janë siguruar nga Divizioni i Personelit, në baza mujore. Llogaritjet e pagave vjetore dhe rrumbullakimi i numrave është bërë nga RrGGK-ja.

## Divizioni për Inspektim të Mbrojtjes së Mjedisit, Natyrës dhe Ujërave

Divizioni për Inspektim të Mbrojtjes së Mjedisit, Natyrës dhe Ujërave mbikëqyr: aplikimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit; aktivitetet që shkaktojnë çrregullime në mjedis, duke identifikuar edhe palën përgjegjëse që e shkakton këtë çrregullim; cilësinë e ajrit, ujit, dheut, natyrës; menaxhimin e burimeve natyrore nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit; masat për mbrojtjen e mjedisit, dhe menaxhimin e burimeve ujore. Ky divizion kontrollon dhe monitoron gjithashtu edhe të gjitha aktivitetet e tjera që lidhen me përdorimin e duhur të ujit, në harmoni me legjislacionin në fuqi.<sup>87</sup>

Në tabelën 20 ilustron numri i kërkesave të shkruara që ka pranuar Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit gjatë periudhës shkurt-qershor 2016. Nga 12 kërkesat e parashtruara, vetëm njëra (8.3%) ishte parashtruar nga një grua. Në tabelën 21 jepen të ndara llojet e kërkesave të parashtruara: kërkesa, ankesa, dhe peticione. Gratë piren të parashtrorë më pak ankesa, kërkesa dhe peticione lidhur me inspektimet mjedisore sesa burrat.

Grua	Burra	Institucione	Gjithsej
1 (8.3%)	9 (75.0%)	2 (16.7%)	12

Kërkesa				Ankesa				Peticione			
Grua	Burra	Institucione	Gjithsej	Grua	Burra	Institucione	Gjithsej	Grua	Burra	Institucione	Gjithsej
1 (12.5%)	5 (62.5%)	2 (25.0%)	8	0 (0.0%)	2 (100%)	0 (0.0%)	2	0 (0.0%)	2 (100%)	0 (0.0%)	2

## Divizioni për Inspektim të Ndërtimit dhe Planifikimit

Divizioni për Inspektim të Ndërtimit dhe Planifikimit përgatit planin vjetor të punës, mbikëqyr aplikimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe planifikimin hapësinor, dhe mbikëqyr të gjitha aktivitetet në ndërtim dhe planifikim në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.<sup>88</sup> Divizioni nuk ka dërguar informata të ndara sipas gjinisë. Informatat lidhur me gjininë e inspektorëve, gjininë e pronarëve dhe menaxherëve të bizneseve të inspektuara, si dhe me gjininë e punonjësve në bizneset e inspektuara do të mund të ishin të dobishme për të shërbyer si bazë për punën e divizionit.

### Objektivat e rekomanduara

1. Të rritet përqindja e grave që punojnë në departament dhe në divizionet e tij nga 29% që është në vitin 2016 në 31% në vitin 2017, duke rritur në këtë mënyrë përqindjen e shpenzimeve për gratë në kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve.
2. Të rritet numri dhe përqindja e llojeve të ndryshme të kërkesave të parashtruara nga gratë nga një (8.3%) që ishte në gjysmën e parë të vitit 2016 në 20 (50%) në vitin 2017.

### Aktivitetet e rekomanduara

1. Duke marrë parasysh që buxheti parashikon punësimin e një anëtari tjetër të personelit, të përdoret një veprim afirmativ për t'i nxitur gratë të aplikojnë, si dhe për t'u dhënë pikë shtesë kandidateve (grua) gjatë procesit të marrjes në punë, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore.
2. Të rritet ndërgjegjësimi në radhët e grave lidhur me të drejtat e tyre dhe procedurat për parashtrimin e kërkesave dhe ankesave me shkrim. Kjo mund të kryhet në bashkëpunim me organizatat lokale të grave dhe përmes një shpalljeje publike për shërbime në televizionin publik – RTK, me pak ose aspak kosto. Kjo mund të kontribuojë në sigurimin që nga shërbimet e ofruara

<sup>87</sup> Rregullorja QRK - Nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Neni 22.

<sup>88</sup> Po aty, neni 23.

nga ky divizion të përfitojnë si gratë ashtu edhe burrat, dhe që gratë dhe burrat të marrin reagime me kohë lidhur me rreziqet potenciale mjedisore.

## Zyra e Projektit për Fshatin Hade

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) i ka zgjeruar operacionet e saj të mihjes. Zgjerimi i kësaj sipërfaqeje për mihje do të kërkojë zhvendosjen fizike dhe ekonomike të disa pjesëve të fshatit Hade, sidomos të lagjes "Shala". Zyra e Projektit për fshatin Hade është themeluar për të ndihmuar në planifikimin e evakuimit dhe zhvendosjes së banorëve. Në vitin 2009, qeveria e ngarkoi zyrtarisht Zyrën për Haden me detyrën e udhëheqjes së procesit të zbatimit të planit për zhvendosjen e lagjes "Shala".<sup>89</sup> Në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, si politikë publike, ky plan për zhvendosje duhet të marrë parasysh nevojat dhe prioritetet potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në fshatin Hade. Plani për rivendosje është hartuar në pajtim me standardet ndërkombëtare, siç janë Politikat Operative të Bankës Botërore për Rivendosjet Jo-Vullnetare dhe Standardet e Performancës të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (KFN) për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale.<sup>90</sup> Është e qartë se këto kërkojnë që masat të përfshijnë perspektivën gjinore dhe atë të të drejtave të njeriut, me qëllim që të plotësohen nevojat e grupeve të cënueshme brenda komunitetit të rivendosur,<sup>91</sup> dhe të identifikohen rreziqet potenciale dhe ndikimet që ka procesi i rivendosjes së këtyre grupeve.<sup>92</sup>

Megjithatë, plani për rivendosjen e Hades do të mund të përfshinte më shumë elementë të perspektivës gjinore, përmes zbatimit të strategjive për stimulimin e pjesëmarrjes së grave në takime publike dhe në proceset e ankimimit. Plani gjithashtu parasheh edhe krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe institucioneve të reja në ambientin e ri ku do të bëhet rivendosja, siç është shkolla, qendra mjekësore, institucione të kujdesit ditor, dhe qendër për sporte dhe çlodhje. Aktualisht, gratë përbëjnë përafërsisht 16% të 135 punonjësve aktivë në komunitet.<sup>93</sup> Veprimet afirmative do të mund të përdoren për të rritur përqindjen e punonjësve, pas krijimit të pozitave të reja të përmendura më sipër.

### Objektivat e rekomanduara

1. Të sigurohet që perspektiva gjinore të integrohet në kuadrin e planit të zhvendosjes për lagjen Shala.

### Aktivitetet e rekomanduara

1. Të shqyrtohet plani i zhvendosjes për lagjen Shala me qëllim që të sigurohet që perspektiva gjinore të integrohet në të. Kjo mund të kryhet nga ZBGJ-ja, në konsultime me ekspertët e çështjeve gjinore dhe me organizatat lokale të cilat punojnë me gratë në zonat e prekura. Të organizohen konsultime publike lidhur me draft-planin, së bashku me gra dhe burra, duke siguruar pjesëmarrjen aktive të grave, me qëllim që të diskutohen nevojat dhe prioritetet e tyre si pjesë e rivendosjes. Të tregohet kujdes që çështjet që dalin gjatë këshillimeve të përfshihen në planin e rishikuar. Të përdoren veprime afirmative për të rritur punësimin në radhët e grave në fshat kurdoherë që është e mundur.

<sup>89</sup> Plani i Veprimit për Zhvendosje: Projekti për lagjen Shala në fshatin Hade, Kosovë, 2011, f. 18, marrë nga: [http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Plani\\_i\\_veprimit\\_per\\_zhvendosje-Lagjia\\_ShalaHade\\_-\\_ENG.pdf](http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Plani_i_veprimit_per_zhvendosje-Lagjia_ShalaHade_-_ENG.pdf).

<sup>90</sup> Po aty.

<sup>91</sup> Banka Botërore, *World Bank Operational Policies for Involuntary Resettlements*, [Politikat Operative të Bankës Botërore për Rivendosjet Jo-Vullnetare], Masat e nevojshme, neni 8, fq.4, 2001, marrë nga: <http://siteresources.worldbank.org/INTFORESTS/Resources/OP412.pdf>.

<sup>92</sup> Grupi KFN i Bankës Botërore, *IFC Performance Standards on Environmental and Social Sustainability*, Identification of Risks and Impacts [Standardet e Performancës të KFN-së për Qëndrueshmëri Mjedisore dhe Sociale], fq. 7, 2012, at: [http://www.ifc.org/wps/wcm/connect/c8f524004a73daeca09afdf998895a12/IFC\\_Performance\\_Standards.pdf?MOD=AJPE RES](http://www.ifc.org/wps/wcm/connect/c8f524004a73daeca09afdf998895a12/IFC_Performance_Standards.pdf?MOD=AJPE RES).

<sup>93</sup> Plani i Veprimit për Zhvendosje: Projekti për lagjen Shala në fshatin Hade, Kosovë, 2011, f. 30, marrë nga:



## Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është përgjegjës për monitorimin e gjendjes së mjedisit dhe natyrës. Ai krijon dhe administron bazat e të dhënave për mjedisin dhe sistemet e informimit. AMMK-ja analizon të dhëna dhe harton raporte për gjendjen e mjedisit. AMMK-ja ka disa institute, duke përfshirë Institutin për Mbrojtjen e Natyrës, Institutin për Hidro-meteorologji dhe Institutin për Planifikim Hapësinor. Më tej, AMMK-ja ka Drejtorinë e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", Drejtorinë e Parkut Kombëtar të Sharrit dhe Drejtorinë për Gjendjen e Mjedisit (tashmë i quajtur Drejtoria për Monitorimin, Vlerësimin dhe Raportimin Mjedisor).<sup>94</sup> Buxheti i AMMK-së për vitin 2017 do të mbetet pothuaj i njëjtë me atë të vitit 2016, me përjashtim të një rënieje në kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve dhe të një rritjeje në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve. Ngjashëm me departamentet e tjera, shpenzimet kapitale të planifikuara nuk janë reflektuar ende në tabelën e buxhetit të departamenteve individuale.

### Pagat dhe mëditjet

Në tabelën 22 ilustron numri dhe përqindja e anëtarëve dhe anëtareve të personelit të AMMK-së, agjencive, instituteve dhe drejtorive të saj, që prej majit të vitit 2016.

	Numri total i anëtarëve të stafit	# dhe % e grave	# dhe % e burrave
Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës	4	1 (25%)	3 (75%)
Instituti për Mbrojtjen e Natyrës	6	1 (17%)	5 (83%)
Instituti për Hidro-meteorologji	21 <sup>96</sup>	4 (19%)	17 (81%)
Instituti për Planifikim Hapësinor	12	5 (42%)	7 (58%)
Drejtoria për Sistemin e Informatave për Mjedisin	3	2 (67%)	1 (33%)
Drejtoria e Parkut Kombëtar të Sharrit	19	0 (0%)	19 (100%)
Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	2	0 (0%)	2 (100%)
Drejtoria për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim Mjedisor	13	3 (23%)	10 (77%)
<b>Gjithsej</b>	<b>80</b>	<b>16 (20%)</b>	<b>64 (80%)</b>

Në gushtin e vitit 2016, në AMMK kishte të punësuar më shumë burra sesa gra, duke përbërë 79% të punonjësve (tabela 23). Në përgjithësi, AMMK-ja ka shpenzuar rreth 77% të pagave dhe mëditjeve për burra dhe 23% për gra.

Niveli i pagës	Numri i përgjithshëm i personelit në çdo nivel page	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201-400	42	37 (88%)	€142,513 (86%)	5 (12%)	€22,714 (14%)	€165,227
401-600	31	20 (65%)	€111,940 (65%)	11 (35%)	€61,210 (35%)	€173,151
600+	7	6 (86%)	€50,637 (87%)	1 (14%)	€7,353 (13%)	€57,990
<b>Gjithsej</b>	<b>80</b>	<b>63 (79%)</b>	<b>€305,091 (77%)</b>	<b>17 (21%)</b>	<b>€91,276 (23%)</b>	<b>€396,367</b>

<sup>94</sup> Faqja e internetit e AMMK-së, Rregullorja Nr. 03/2014 e MMPH-së për Organizimin e Brendshëm dhe Sistemin e Punëve në Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, marrë nga: [http://mmp-h-rks.org/repository/docs/ministri-projekt-rregullorja\\_per\\_organizim\\_te\\_brendshem-ammk-1312-14\\_437699.pdf](http://mmp-h-rks.org/repository/docs/ministri-projekt-rregullorja_per_organizim_te_brendshem-ammk-1312-14_437699.pdf).

<sup>95</sup> Të dhënat janë ofruar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, 23 maj 2016.

<sup>96</sup> Përfaqësues të këtij instituti thanë se ka 17 punonjës, 7 korrik 2016.

<sup>97</sup> Të dhënat janë siguruar nga Divizioni i Personelit, në baza mujore. Llogaritjet e pagave vjetore dhe rrumbullakimi i numrave është bërë nga RrGGK.



## Instituti për Mbrojtjen e Natyrës

Instituti për Mbrojtjen e Natyrës për përgjegjës për mbledhjen e të dhënave, monitorimin e diversitetit biologjik dhe peizazheve, dhe propozimin e masave për mbrojtjen e tyre. Ai kryen edhe analiza statistikore dhe shkruan raporte lidhur me mbrojtjen e natyrës. Ky institut mbikëqyr zbatimin e dokumenteve kombëtarë në këtë fushë dhe përgatit standarde profesionale për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës.<sup>98</sup> Ndërkohë që Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës harton politika për mbrojtjen e natyrës, Instituti kryen punën profesionale për mbrojtjen e natyrës. Nuk janë ofruar të dhëna të mëtejshme të ndara sipas gjinisë, pavarësisht përpjekjeve.

## Instituti për Hidro-meteorologji

Instituti për Hidro-meteorologji mbetet një rrjet i stacioneve hidrologjike dhe meteorologjike. Ai organizon matjet e faktorëve dhe dukurive hidrologjike, meteorologjike, bio-meteorologjike dhe hidro-biologjike. Instituti ofron edhe parashikime të motit, monitoron cilësinë e ajrit, dhe studion se si ndikojnë në biosferë moti, klima dhe ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësorë. Lidhur me këto çështje, ky organ shkruan raporte. Instituti ka dy sektorë: Sektorin e Hidrologjisë, i cili monitoron ujërat sipërfaqësorë dhe Sektorin e Laboratorit, i cili kryen analiza fiziokimike të cilësisë së ujit, dheut dhe ajrit.<sup>99</sup> Ky institut nuk e ka integruar ende perspektivën gjinore kur studion se si preken burrat dhe gratë në mënyra të ndryshme nga ndryshimet e motit, klimës dhe ujit.<sup>100</sup> Megjithatë, UNDP ka mbështetur një vlerësim mbi gjininë dhe adaptimin e ndryshimeve klimatike që mund të informojë krijimin e politikave dhe programimin e këtij Instituti dhe MMPH-së më gjerësisht në të ardhmen, në konsultim të ngushtë me ministrinë e tjera përkatëse dhe aktorët joqeveritarë.<sup>101</sup> Buxheti i Institutit është i përbashkët me atë të AMMK-së.

### Pagat dhe mëditjet

Linja buxhetore e Institutit për pagat dhe mëditjet ka mbetur e njëjta çdo vit, gjatë periudhës 2014-2016 (66,969 euro), gjatë së cilës Instituti ka pasur 17 punonjës. Në tabelën 24 tregohet se në Institutin Hidro-Meteorologjik, vetëm 29% e punonjësve janë gra, dhe 31% e pagave dhe mëditjeve shpenzohen për gra.

Niveli i pagës	Numri i përgjithshëm i personelit në çdo nivel page	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201-400	15	11 (73%)	€3,447 (74%)	4 (27%)	€1,235.4 (26%)	€4,682.8
401-600	2	1 (50%)	€402 (45%)	1 (50%)	€496.18 (55%)	€897.98
<b>Totali</b>	<b>17</b>	<b>12 (71%)</b>	<b>€3,849 (69%)</b>	<b>5 (29%)</b>	<b>€1,732 (31%)</b>	<b>€5,581</b>

Pjesëmarrja në trajnime dhe udhëtime zyrtare financohet përmes kategorisë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve. Në tabelën 25 ilustron se vetëm 10% e pjesëmarrësve në trajnimet e ofruara nga Instituti Hidro-Meteorologjik kanë qenë gra.<sup>102</sup> Më tej, gratë kanë qenë të nënpërfaqësuar

<sup>98</sup> Faqja e internetit e AMMK-së, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës, marrë nga: <http://www.ammk-rks.net/?page=1,118>.

<sup>99</sup> Faqja e internetit e AMMK-së, Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës, marrë nga: <http://www.ammk-rks.net/?page=1,127>.

<sup>100</sup> Letërkëmbim i RrGGK-së me zyrtarë, 7 korrik 2016.

<sup>101</sup> Për informata të mëtuqeshme dhe rekomandime më specifike, shih: UNDP, Përfshirja e Çështjes Gjinore në Politikat dhe Strategjitë për Përshtatje ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore, Prishtinë: UNDP, 2016, në: [http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/environment\\_energy/the-gender---drr---cca-report.html](http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/environment_energy/the-gender---drr---cca-report.html).

<sup>102</sup> RrGGK-ja ka kërkuar të dhëna lidhur me të gjitha trajnimet që u janë ofruar punonjësve na ana e këtij Instituti. Megjithatë, Instituti dërgoi të dhëna vetëm lidhur me trajnimet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Kjo do të thotë se numrat nuk përfaqësojnë të gjithë punonjësit dhe të gjitha trajnimet që janë zhvilluar gjatë periudhës 2014-2016.

në udhëtimet zyrtare, duke përbërë vetëm 30% të pjesëmarrësve. Edhe pse nuk janë ofruar të dhëna të sakta lidhur me shpenzimet, mund të kuptohet se nga shpenzimet lidhur me trajnimin dhe mëditjet për punonjësit, prirje për të përfutur ka pasur një numër më i madh i burrave sesa i grave.

	# dhe % e grave	# dhe % e burrave	Gjithsej
Pjesëmarrës në trajnime	1 (10%)	9 (90%)	10
Pjesëmarrës në udhëtime zyrtare	5 (30%)	14 (70%)	20
<b>Totali</b>	<b>5 (29%)</b>	<b>12 (71%)</b>	<b>17</b>

## Instituti për Planifikim Hapësinor

Ky institut krijon Planin Hapësinor të Kosovës dhe planifikon zonat e veçanta të interesit për shtetin, siç janë Bjeshkët e Nemuna, Sharri dhe Mirusha. Krahas kësaj, ai zhvillon edhe kapacitetet njerëzore dhe iu ofron ndihmë teknike dhe profesionale punonjësve në nivel komunal, në kuadrin e përgatitjeve të planeve komunale.<sup>103</sup> Meqenëse këto janë politika publike, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, Instituti duhet të sigurohet që në dokumentet e planifikimit hapësinor të komunave të përfshihet një perspektivë gjinore, duke mbajtur parasysh nevojat dhe përdorimet potencialisht të ndryshme të hapësirës publike nga ana e grave dhe burrave të ndryshëm.

### Pagat dhe mëditjet

Sikurse ilustron në tabelën 26, në vitin 2016, Instituti për Planifikim Hapësinor ka punësuar një numër të barabartë të grave dhe burrave. Megjithatë, burrat përfitojnë disi më shumë nga shpenzimet nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve sepse në nivelin më të lartë të pagës është punësuar një burrë. Pavarësisht kësaj, ky Institut i ka të baraspeshuara shpenzimet për punonjëset dhe punonjësit.

Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
401-600	9	4 (44%)	€22,800 (45%)	5 (56%)	€28,320 (55%)	€51,120
600+	1	1 (100%)	€7,320 (100%)	0 (0%)	€0 (0%)	€7,320
<b>Gjithsej</b>	<b>10</b>	<b>5 (50%)</b>	<b>€30,120 (52%)</b>	<b>5 (50%)</b>	<b>€28,320 (48%)</b>	<b>€58,440</b>

### Programet dhe aktivitetet

Instituti ka organizuar seanca dëgjimore publike, si për shembull për planin hapësinor të Bjeshkëve të Nemuna. Pjesa më e madhe e atyre që morën pjesë në këto seanca dëgjimore ishin burra. "Kur iu kërkuan pjesëmarrësve t'i njoftonin gratë që të vinin në seancat dëgjimore publike, ata thanë, për shembull, "Përse ju duhen gratë?" u shpreh Udhëheqësi i Institutit.<sup>105</sup> Në këto situata, praktikat më të mira në komunitetet në Kosovë kanë treguar se mund të jetë e dobishme të bashkëpunohet me organizatat lokale të grave për të organizuar takime me gratë, të veçuara nga ato të burrave, për të dëgjuar idetë dhe shqetësimet specifike të grave. Nëse ekziston nevoja për vendime të përbashkëta nga ana e komunitetit, më vonë mund të organizohet një takim tjetër ku mund të përfshihen si gratë, ashtu edhe burrat, me përkrahjen e organizatave lokale.

<sup>103</sup> Faqja e internetit e AMMK-së, Instituti për Planifikim Hapësinor, marrë nga: <http://www.ammk-rks.net/?page=1,94>.

<sup>104</sup> Të dhënat nga kjo tabelë, janë ofruar nga Instituti për Planifikimin Hapësinor. Instituti nuk ka ndonjë linjë buxhetore, meqenëse buxheti i tij vjen nga AMMK-ja. Në tabelë paraqiten pagat e neto të rrumbullakosura, sipas koeficientëve të punonjësve.

<sup>105</sup> Bashkëbisedim me RrGGK-në, 16 maj 2016.

Për sa u takon dokumenteve strategjike, Udhëheqësi i Institutit deklaroi se këto janë të qasshme për cilindo në faqen e internetit të Institutit, "pa diskriminim mbi bazë gjinore, moshe, feje, profesioni, etj."<sup>106</sup> Megjithatë, grupe të caktuara mund të mos jenë në gjendje t'i shqyrtojnë këto dokumente dhe të kontribuojnë në to, për shkak të mungesës së internetit në rajone të caktuara ose në radhët e gjinive, grupmoshave apo grupeve të caktuara fetare. Disa grupe mund të mos kenë njohuri lidhur me politikë-bërjen apo mënyrën e pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes.

Lidhur me planifikimin urban në komuna specifike, zyrtarët komunalë kanë organizuar disa konsultime me qytetarë. Për shembull, Ministria e Prishtinës ka organizuar konsultime me qytetarë lidhur me planifikimin urban. Pavarësisht kësaj, organizata joqeveritare si *Ec Ma Ndryshe* kanë "vënë re disa mangësi në lidhje me organizimin e këtyre diskutimeve." Në një deklaratë për shtyp, organizata pohoi se, "*Mënyra e njoftimit të qytetarëve dhe targetimi jo gjithëpërfshirës i grupeve të komunitetit ka prodhuar diskutime publike me mbi 90% pjesëmarrës të gjinisë mashkullore [sic].*"<sup>107</sup> Është e rëndësishme që ky departament dhe divizionet e tij t'iu ofrojnë udhëzime komunave dhe t'i përkrahin ato në zbatimin e praktikave më të mira në organizimin e seancave dëgjimore publike, duke siguruar pjesëmarrjen e grave dhe burrave të ndryshëm. Përndryshe, nevojat dhe prioritetet e tyre mund të mos merren parasysh si duhet në hartimin e planeve hapësinore, dhe, për rrjedhojë, planifikimi hapësinor mund të mos i plotësojë nevojat e tyre potencialisht të ndryshme.

## **Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"**

MMPH-ja ka krijuar Drejtorinë e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" për ta menaxhuar këtë park.<sup>108</sup> AMMK-ja administron buxhetin e kësaj drejtorie. Drejtoria nuk ka ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë, pavarësisht kërkesës.

## **Drejtoria e Parkut Kombëtar të Sharrit**

Drejtoria e Parkut Kombëtar të Sharrit menaxhon përdorimin e burimeve natyrore dhe duhet të plotësojë infrastrukturën ligjore për menaxhim të qëndrueshëm të këtij parku. Ajo bashkëpunon me qeveritë lokale dhe komunat, policinë, prokurorë, gjykata, inspektorë, brigadën e zjarrfikësve dhe shoqata ekologjike. Kjo drejtori ka dy sektorë: Sektorin e Pylltarisë dhe Sektorin e Biologjisë.<sup>109</sup> AMMK-ja administron buxhetin e kësaj drejtorie. Të 18 punonjësit janë burra.<sup>110</sup> Prandaj, 100% e shpenzimeve nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve shpenzohen për burrat. Drejtoria nuk ka ofruar të dhëna të mëtejshme të ndara sipas gjinisë në lidhje me punën e saj, pavarësisht kërkesave.

## **Drejtoria për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim Mjedisor**

Kjo drejtori harton kriteret për monitorim, duke u mbështetur në standardet dhe treguesit mjedisorë evropianë dhe kombëtarë. Poashtu mbledh informata nga ndotësit në Kosovë, duke përfshirë të dhëna, ndër të tjera, lidhur me sektorin e energjisë, industrisë, transportit, bujqësisë dhe pylltarisë. Krahas kësaj, ky organ mbledh të dhëna lidhur me gjendjen e cilësisë së ajrit, ujërave dhe dherave, si dhe atë të natyrës, biodiversitetit, mbetjeve dhe mjedisit. Ajo ka detyrën e shqyrtimit të marrëdhënieve midis këtyre dhe shëndetit. Drejtoria organizon edhe monitorimin e ndryshimeve në mjedis, në pajtim me kërkesat e MMPH-së, planeve strategjike dhe programeve. Kjo drejtori kryen analiza kimike, përpunon të dhënat e mbledhura dhe vlerëson paraprakisht incidentet e mundshme

<sup>106</sup> Letërkëmbim elektronik me Udhëheqësin e Institutit për Planifikim Hapësinor, 2 qershor 2016.

<sup>107</sup> *Ec Ma Ndryshe*, deklaratë për shtyp, *Diskutimet publike për planet urbane në Prishtinë duhet të jenë gjithëpërfshirëse*, Prishtinë: 2014, marrë nga: [http://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,258#.V\\_c\\_keV9670](http://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,258#.V_c_keV9670).

<sup>108</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", neni 4, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20Parkun%20Kombetar%20-Bjeshket%20e%20Nemuna.pdf>.

<sup>109</sup> Faqja e internetit e AMMK-së, Drejtoria e Parkut Kombëtar të Sharrit, marrë nga: <http://www.ammk-rks.net/?page=1,123>.

<sup>110</sup> Letërkëmbim elektronik me drejtorinë, 29 qershor 2016.

mjedisore që mund të ndodhin.<sup>111</sup> Në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, Drejtoria duhet të kryejë analiza gjinore si pjesë e këtyre analizave. Këtu përfshihet mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë, lidhur me mënyrën se si ndotja apo cilësia e dobët e ajrit, ujit dhe dheut mund të ndikojë në mënyra të ndryshme të gratë, burrat, vajzat dhe djemtë.

Megjithatë, kjo drejtori nuk ka kryer asnjëherë ndonjë analizë gjinore lidhur me mënyrat e ndryshme në të cilat preken gratë dhe burrat nga mjedisi apo programet mjedisore.<sup>112</sup> Udhëheqësi i Drejtorisë ka marrë pjesë në trajnime lidhur me tema të ndryshme, duke përfshirë edhe energjetikën, ku janë trajtuar problemet gjinore, të tilla si ndikimi që kanë rolet gjinore brenda familjes në mbrojtjen e mjedisit. Megjithatë, ky trajnim nuk e ka ndryshuar mënyrën se si e kryen punën e saj kjo drejtori.<sup>113</sup>

## Pagat dhe mëditjet

Sikurse ilustron tabelën 27, në këtë drejtori gratë përbëjnë 38.5% të punonjësve. Të pozicionuara në nivelin e pagës më të ulët (€201-400), gratë përbëjnë 100% të punonjësve, ndërkohë që përfaqësojnë 40% të punonjësve me pagë mesatare dhe 0% të atyre në nivelin më të lartë të pagës. Edhe pse nuk janë ofruar të dhëna reale lidhur me shpenzimet për gratë dhe burrat, mund të kuptohet se për burrat shpenzohet një pjesë më e madhe e kategorisë ekonomike të pagave dhe mëditjeve sesa për gratë.

Niveli i pagës	Numri i përgjithshëm i personelit në çdo nivel page	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201-400	1	0 (0%)		1 (100%)		
401-600	11	7 (60%)		4 (40%)		
600+	1	1 (100%)		0 (0%)		
Gjithsej	13	8 (61.5%)		5 (38.5%)		

## Objektivat e rekomanduara

1. Të rritet përqindja e grave që punojnë në AMMK nga 21% në vitin 2016 në 24% në vitin 2017, duke e ngritur kështu përqindjen e kategorisë ekonomike të pagave dhe mëditjeve të shpenzuara për gra.
2. Të tregohet kujdes që ndërgjegjësimi lidhur me mbrojtjen e natyrës të përmbushë nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave për komunikim.
3. Të rritet përqindja e grave nga Instituti Hidro-Meteorologjik, të cilat mund të marrin pjesë në udhëtime zyrtare (30%) dhe të përfitojnë nga trajnime (10%).
4. Të sigurohet që perspektiva gjinore të përfshihet në shqyrtimin e të gjitha dokumenteve të planifikimit hapësinor në nivel komune.
5. Të përmirësohet perspektiva gjinore brenda planeve për zhvillim hapësinor, duke përfshirë parqet kombëtare.
6. Të përmirësohet përfshirja e analizës gjinore në monitorimin, vlerësimin dhe raportimin për mjedisin.

## Aktivitetet e rekomanduara

1. AMMK-ja mund të përdorë veprime afirmative në rekrutimin e tri anëtarëve shtesë të personelit, në drejtim të çuarjes më tutje të baraspeshës gjinore midis grave dhe burrave, në pajtim me Ligjin

<sup>111</sup> Faqja e internetit e AMMK-së, Drejtoria për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim Mjedisor, marrë nga: <http://www.ammk-rks.net/index.php?page=1.30>.

<sup>112</sup> Intervistë e RrGGK-së me Drejtorinë e Monitorimit, Vlerësimit dhe Raportimit Mjedisor, 12 maj 2016.

<sup>113</sup> Po aty.

për Barazi Gjinore. Kjo nuk do të ketë kosto shtesë dhe do të kontribuojë për të garantuar që AMMK-ja i zbaton detyrimet e saj ligjore për të siguruar përfaqësim të barabartë gjinore, në harmoni me Ligjin për Barazi Gjinore.

2. Në përgatitjen e masave për mbrojtjen e natyrës, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës duhet të marrë parasysh rrugët më të mira për të mbërritur te gratë, burrat, vajzat dhe djemtë për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me rëndësinë që ka mbrojtja e natyrës. Planet e komunikimit dhe të ndërgjegjësimit duhet të mbajnë parasysh nevojat dhe interesat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave për komunikim. Materialet për komunikim mund të shqyrtohen për të siguruar që nuk janë të anshëm në lidhje me çështjet gjinore. ZBGJ-ja mund të përfshihet në këtë proces dhe organizatat për të drejtat e grave mund të konsultohen pa i shkaktuar Ministrisë kosto shtesë.
3. Të përdoren veprime afirmative për të dërguar më shumë nga Instituti i Hidro-meteorologjik si përfaqësuese zyrtare, si dhe për të marrë pjesë në trajnime, duke kontribuar kështu në shpenzime më të barabarta nga kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.
4. Instituti për Planifikim Hapësinor duhet të shqyrtojë të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor komunal për të siguruar që në to të përfshihet perspektiva gjinore, dhe duhet të këshillojë komunat gjatë procesit të hartimit të këtyre planeve. Këtu përfshihet edhe marrja parasysh nevojat potencialisht të ndryshme të burrave dhe grave dhe mënyra se si ata i përdorin hapësirat publike, si dhe këshillimi i komunave për të zhvilluar konsultime me gra dhe burra të ndryshëm në formulimin e planeve të tyre hapësinore. ZBGJ-ja duhet të përfshihet në këtë proces dhe duhet të zhvillohen konsultime me ekspertë lokalë të çështjeve gjinore, gjë që nuk do të kërkojë domosdoshmërisht burime shtesë.
5. Të organizohen konsultime publike të veçuara me gratë në bashkëpunim të ngushtë me organizatat lokale të grave, me qëllim që të mund të dëgjohen edhe prioritetet dhe nevojat e tyre lidhur me planifikimin hapësinor dhe parqet kombëtare. Drejtoria mund të marrë parasysh heqjen mënjane të burimeve shtesë minimale për qëllime të këtyre mbledhjeve, nëse paraqitet nevoja.
6. Drejtoria për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim Mjedisor duhet të sigurojë që të mblidhen dhe të analizohen të dhëna të ndara sipas gjinisë, të cilat kanë të bëjnë me ndikimin që ka ndotja dhe cilësia e ajrit, dheut dhe ujit, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Këtu përfshihet edhe vëmendja ndaj mënyrës se si format e ndryshme të ndotjes mund të kenë ndikime të ndryshme te gratë, burrat, vajzat dhe djemtë. Kjo mund të bëhet në bashkëpunim me ASK-në. Përfshirja e pyetjeve në anketën ekzistuese nuk do të shkaktonte ndonjë kosto shtesë për Ministrinë.

## Agjencia Kadastrale e Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) mirëmban infrastrukturën e të dhënave gjeo-hapësinore, bazën e të dhënave kadastrale, regjistrat e pasurive dhe hartëzimin. Ajo administron sistemin e kompjuterizuar kombëtar që merret me të dhënat kadastrale, dhe licencon kompanitë dhe matësit që kryejnë matjet kadastrale. Ajo mund të nxjerrë edhe udhëzime lidhur me veprimtaritë kadastrale.<sup>114</sup> Kjo Agjenci ka këto njësi kadastrale: parcelat kadastrale, ndërtesat, pjesët e ndërtesave dhe shërbimet komunale.<sup>115</sup> Ajo përbëhet nga pesë drejtori dhe sektorët e tyre,<sup>116</sup> si dhe nga Sektori i Prokurimit. Drejtoratet e AKK-së janë:<sup>117</sup> Drejtorati i Regjistratit mbi Pronat e Paluajtshme (RDPP),<sup>118</sup> Drejtorati për

<sup>114</sup> Ligji nr. 04/L-013 për Kadastër, neni 4, marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2757>.

<sup>115</sup> Po aty, neni 7.

<sup>116</sup> Sektori për Kadastër, GIS dhe Matje harton sistemin e informatave kadastrale. Ai merret edhe me vektorizimin, transformimin dhe planifikimin e hartave kadastrale, dhe krijimin e standardeve për matje gjeodekike dhe kadastrale për zyrat kadastrale, kompanitë dhe gjeodetët e licencuar (faqja e internetit e AKK-së, Rregullorja Nr. 20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, neni 7, marrë nga: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE\\_ORK\\_NR.20.2014\\_PER\\_ORGANIZIMIN\\_E\\_BRENDSHEM\\_DHE\\_SISTEMATIZIMI\\_N....pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_ORK_NR.20.2014_PER_ORGANIZIMIN_E_BRENDSHEM_DHE_SISTEMATIZIMI_N....pdf)).

<sup>117</sup> Po aty, Organogrami i AKK-së, faqe 41.

Gjeoinformacion, Drejtorati për Menaxhimin e Sistemit të Teknologjisë së Informacionit Kadastral,<sup>119</sup> Drejtorati Ligjor,<sup>120</sup> dhe Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.<sup>121</sup>

Në draft buxhetin për vitin 2017, buxheti i tij quhet "shërbimet kadastrale", ndërsa në buxhetin e Kosovës për vitin 2016 "shërbimet kadastrale" ishin në varësi të Agjencisë Kadastrale. Ndërkohë që AKK-ja ka planifikuar që numri i punonjësve të mbetet i njëjtë, ajo ka parashikuar një rënie prej më shumë sesa 40,000 euro në shpenzime për paga dhe mëditje në vitin 2017. Në të njëjtën kohë, parashikohet një rritje në shumë të ngjashme edhe për kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve. Investimet kapitale nuk janë specifikuar edhe në buxhetin e Agjencisë, por janë përfshirë në buxhetin e përgjithshëm të MMPH-së.

## Pagat dhe mëditjet

Siç ilustron në tabelën 28, gratë kanë mbetur vazhdimisht të nën-përfaqësuara brenda Agjencisë, ndërkohë që përfaqësimi i tyre ka rënë që prej vitit 2014.

Viti	Numri total i anëtarëve të stafit	# dhe % e grave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma e shpenzuar për burrat	Shuma totale e shpenzuar
2014	51	20 (39%)	31 (61%)	€111,274 (39%)	€171,949 (61%)	€283,223
2015	50	19 (38%)	32 (64%)	€132,828 (40%)	€202,763 (60%)	€335,591
2016	57	19 (33%)	38 (67%)	€135,756 (36%)	€237,124 (64%)	€372,880
Planifikuar për vitin 2017	57	19 (33%)	38 (67%)	€135,756 (36%)	€237,124 (64%)	€372,880

Në vitin 2016, gratë përbënin 33% të punonjësve dhe merrnin 36% të shpenzimeve nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve. Kjo është parashikuar të mbetet e njëjtë në vitin 2017.

Niveli i pagës	Numri i përgjithshëm i personelit në çdo nivel page	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma e përgjithshme që do të shpenzohet
201-400	11	9 (82%)	€35,476 (80%)	2 (18%)	€8,804 (20%)	€44,280
401-600	35	23 (66%)	€134,789 (65%)	12 (34%)	€74,110 (35%)	€208,899
600+	11	6 (55%)	€56,612 (47%)	5 (45%)	€63,089 (53%)	€119,701

<sup>118</sup> Drejtorati i Regjistrimit mbi Pronat e Paluajtshme (RDPP) siguron zbatimin e Ligjit për Kadastër, Ligjit për RDPP dhe Ligjit për Pengjet brenda Zyrrave Kadastrale Komunale (ZKK). Ai mirëmban planet dhe hartat lidhur me kadastrën, kontribuon me informata kadastrale në ZKK, dhe udhëzon ZKK-të lidhur me procedurat e regjistrimit të kadastrës (po aty, neni 6).

<sup>119</sup> Drejtorati për Menaxhimin e Sistemit të Teknologjisë së Informacionit Kadastral siguron që sistemi i TI-së të jetë në dispozicion të përdoruesve të regjistrave kadastrale dhe regjistrave të tjerë të AKK-së. Ajo ofron sigurinë e sistemeve të TI-së të AKK-së dhe e përkrah AKK-në me pajisje të TI-së. Krahas kësaj, administron bazat e të dhënave dhe procedurat e TI-së për migrimin dhe kontrollin e cilësisë së të dhënave (po aty, neni 15).

<sup>120</sup> Drejtorati Ligjor ofron asistencë me hartimin e legjislacionit që lidhet me punën e AKK-së. Siguron harmonizimin e legjislacionit të AKK-së me atë të BE-së dhe pjesën tjetër të legjislacionit në fuqi në Kosovë. Ai bashkëpunon me MMPH-në dhe Ministrinë e Drejtësisë për kontestet juridike, dhe përfaqëson AKK-në (po aty, neni 18).

<sup>121</sup> Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme zbaton procedurat e punësimit për përzgjedhjen e personelit të kualifikuar, menaxhon organizimin e brendshëm të AKK-së dhe ofron ndihmë administrative dhe logjistike. Ai përgatit dhe vlerëson buxhetin e Agjencisë (po aty, neni 21).



## Programet dhe aktivitetet

Siç ilustron në tabelën 30, midis viteve 2013 dhe 2015, 86.3% e kërkesave për kompensim janë parashtruar nga burra. Numri i kërkesave për kompensim ka qenë vazhdimisht më i ulët për gratë sesa për burrat. Krahas 114 gjeodetëve të licencuar në Kosovë, vetëm pesë janë gra (vetëm 4%).<sup>122</sup>

Viti	Gra	Burra	Gjithsej
2013	15 (17%)	73 (83%)	88
2014	1 (14%)	6 (86%)	7
2015	7 (10%)	66 (90%)	73
	<b>23 (14%)</b>	<b>145 (86%)</b>	<b>168</b>

### Objektivat e rekomanduara

1. Të rritet përqindja e shpenzimeve për gratë nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve nga 36% në vitin 2016.
2. Të rritet numri dhe përqindja e kërkesave për kompensim të parashtruara nga gratë nga 9.6% në vitin 2015.
3. Të ndryshohet Ligji për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme në funksion të sigurimit të drejtave të grave në pronë.
4. Të rritet përqindja e gjeodeteve të licencuara nga 4% në vitin 2016.

### Aktivitetet e rekomanduara

1. Kur hapen vende pune, të përdoren veprime afirmative për të përmirësuar barazinë gjinore midis punonjësve, duke kontribuar në shpenzim më të barabartë të kategorisë ekonomike të pagave dhe mëditjeve. Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme mund të lehtësojë përzgjedhjen e grave të kualifikuara përmes përdorimit të veprimeve afirmative në procedurat e marrjes në punë, siç parashikohet me Ligjin për Barazi Gjinore.
2. Të rritet ndërgjegjësimi i grave lidhur me mënyrën e shkrimit dhe parashtrimin të kërkesave për kompensim. Kjo mund të arrihet përmes një shpalljeje për shërbime në televizionin publik – RTK, me pak ose aspak kosto. Të bashkëpunohet me organizatat për të drejtat e grave për të përmirësuar më tej kapacitetet dhe njohuritë e grave lidhur me shkrimin e kërkesave për kompensim.
3. Të nisët ndryshimi i Ligjit për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme me qëllim që të përfshihen në të dispozitat ligjore ku thuhet se institucionet që japin titujt duhet të kërkojnë që palët që regjistrojnë pasurinë të ofrojnë dëshmi lidhur me kohën se kur është krijuar pasuria. Kjo mund të ndihmojë në përmirësimin e regjistrimit të pronës në emër të të dy bashkëshortëve. Për më tepër, kjo do të pamundësojë regjistrimin e pronës vetëm në emrin e njërit bashkëshort. Më tej, të tregohet kujdes që dispozitat ligjore të specifikojnë dhe standardizojnë se cilat dokumente duhet të kërkojnë zyrat kadastrale për të bërë regjistrimin e pronës, sidomos në regjistrimin e pronës në emrat e të dy bashkëshortëve.
4. Të përdoren veprime afirmative për të inkurajuar një numër më të madh të grave që të punojnë si gjeodete.

<sup>122</sup> MMPH, AKK, Lista e Gjeodetëve të Certifikuar, marrë nga: <http://www.kca-ks.org/documents/10179/25744/Licencat+per+Gjeodet+definitive.pdf/a2a47cbd-5aec-4f0f-bb8c-a39f5a0148c6>.

<sup>123</sup> Departamenti i Shpronësimit, letërkëmbim elektronik, 2 janar 2016.

## Punimet e cituara

- ASK, *Vlerësim: Popullsia e Kosovës 2014*, Prishtinë: 2015.2015.
- \_\_\_\_\_, *Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061*, Prishtinë: 2013. Republika e Kosovës, MMPH, *Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit*, marrë nga: <http://mmph-rks.org/sq/Departamenti-per-Mbrojtjen-e-Mjedisit>.
- \_\_\_\_\_, *Vlerësim: Popullsia e Kosovës 2015*, Prishtina: 2016.
- Banka Botërore, Manuali Operacional, *Politikat Operacionale: Zhvendosja jo-vullnetare*, 2001, marrë nga: <http://siteresources.worldbank.org/INTFORESTS/Resources/OP412.pdf>.
- CAP-NET, GWA 2014. *Why Gender Matters in IWRM: A Tutorial for Water Managers*, Full Resource Document [Pse janë të rëndësishme çështjet gjinore në IWRM: Mësime për menaxherët e ujërave; dokument i plotë burimor], marrë nga: <http://www.thewaterchannel.tv/gender/content/img/frd-full-resource-document-web-version.pdf>.
- Ec Ma Ndryshe, deklaratë për shtyp, *Diskutimet publike për planet urbane në Prishtinë duhet të jenë gjithëpërfshirëse*, marrë nga: [http://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,258#.V\\_c\\_keV9670](http://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,258#.V_c_keV9670).
- \_\_\_\_\_, dhe Pro-Planning, *Sfidat e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor në komuna; roli i shoqërisë civile në adresimin e tyre*, Prishtina, 2016, marrë nga: [http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/160530170335\\_EC\\_PRO\\_Analiza\\_SHQ.pdf](http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/160530170335_EC_PRO_Analiza_SHQ.pdf).
- Grupi KFN i Bankës Botërore, *IFC Performance Standards on Environmental and Social Sustainability*, [Standardet e Performancës të KFN-së për Qëndrueshmëri Mjedisore dhe Sociale], 2012, at: [http://www.ifc.org/wps/wcm/connect/c8f524004a73daeca09afd998895a12/IFC\\_Performance\\_Standards.pdf?MOD=AJPERES](http://www.ifc.org/wps/wcm/connect/c8f524004a73daeca09afd998895a12/IFC_Performance_Standards.pdf?MOD=AJPERES).
- Komisioni Evropian, *Blerja Sociale: Udhëzim lidhur me konsiderimin e aspekteve sociale në prokurimin publik*, Luksemburg, 2010, marrë nga: <http://www.bassetlaw.gov.uk/media/29130/BuyingSocial.pdf>.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, marrë nga: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20sh.pdf>.
- \_\_\_\_\_, Ligji nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8981>.
- \_\_\_\_\_, Ligji nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-001%20sh.pdf>.
- \_\_\_\_\_, Ligji nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-071%20sh.pdf>.
- \_\_\_\_\_, Ligji nr. 04/L-013 për Kadastër, marrë nga: [http://mmph-rks.org/repository/docs/cb08d561-588d-4056-98c0-1bb040e0fce5\\_721945.pdf](http://mmph-rks.org/repository/docs/cb08d561-588d-4056-98c0-1bb040e0fce5_721945.pdf).
- \_\_\_\_\_, Ligji nr. 05/L-068 për ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-068%20sh.pdf>.
- \_\_\_\_\_, Ligji nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20Parkun%20Kombetar%20-Bjeshket%20e%20Nemuna.pdf>.
- \_\_\_\_\_, Rregullorja 02/2012, "Për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive", marrë nga: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja\\_02-2011-e\\_miraturar\\_nga\\_Qeveria-finale.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja_02-2011-e_miraturar_nga_Qeveria-finale.pdf).
- \_\_\_\_\_, Rregullorja nr. 19/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Ristrukturimin e Punëve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, marrë nga: [http://kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE\\_ORK\\_NR\\_19-2013\\_PER\\_ORGANIZIMIN\\_E\\_BRENDSHEM\\_DHE\\_SISTEMATIZIM....pdf](http://kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_ORK_NR_19-2013_PER_ORGANIZIMIN_E_BRENDSHEM_DHE_SISTEMATIZIM....pdf).
- \_\_\_\_\_, Rregullorja nr. 20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, marrë nga: [http://www.kca-ks.org/documents/10179/14697/RREGULLORE\\_ORK\\_NR.20.2014\\_PER\\_ORGANIZIMIN\\_E\\_BRENDSHEM\\_DHE\\_SISTEMATIZIMIN....pdf/a3d2acf3-e7f9-4f0e-b644-76fe7691471](http://www.kca-ks.org/documents/10179/14697/RREGULLORE_ORK_NR.20.2014_PER_ORGANIZIMIN_E_BRENDSHEM_DHE_SISTEMATIZIMIN....pdf/a3d2acf3-e7f9-4f0e-b644-76fe7691471).
- \_\_\_\_\_, Rregullorja nr. 03/2014 për Përgjegjësitë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës në Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, marrë nga: [http://mmph-rks.org/repository/docs/ministri-projektregullorja\\_per\\_organizim\\_te\\_brendshem-ammk-1312-14\\_437699.pdf](http://mmph-rks.org/repository/docs/ministri-projektregullorja_per_organizim_te_brendshem-ammk-1312-14_437699.pdf).
- Oxfam, *Gjinia dhe Planifikimi Hapësinor: RTPI praktikata e mira, shënimi 7*, Londër: 2007
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat), *Integrimi gjinor në planifikimin hapësinor: Qasje hap pas hapi për komuna*, Prishtinë: 2014, marrë nga: [http://home.fa.utl.pt/~camarinhas/Gender\\_Mainstreaming\\_in\\_SP.pdf](http://home.fa.utl.pt/~camarinhas/Gender_Mainstreaming_in_SP.pdf).



- Qeveria e Kosovës, MMPH, Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturisë 2013-2017, Prishtinë: 2013, marrë nga: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves\\_per\\_Menaxhimin\\_e\\_Mbeturise\\_2013-2017.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_i_Republikes_se_Kosoves_per_Menaxhimin_e_Mbeturise_2013-2017.pdf).
- \_\_\_\_\_, *Raporti i zhvillimit hapësinor për sektorin e mjedisit*, Prishtinë: 2004, marrë nga: <http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Mjedisi.pdf>.
- \_\_\_\_\_, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020, Prishtinë, marrë nga: [http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_per\\_Biodiversitet\[1\].pdf](http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_per_Biodiversitet[1].pdf).
- \_\_\_\_\_, Strategjia Mjedisore e Kosovës (SMK) dhe Plani Kombëtar të Veprimit Mjedisor (PKVM) 2011-2015, Prishtinë: 2011, marrë nga: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Kosoves\\_per\\_Veprim\\_ne\\_Mjedis\\_2011-2015.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_dhe_Plani_i_Kosoves_per_Veprim_ne_Mjedis_2011-2015.pdf).
- Republika e Kosovës, AMMK, *Detyrat dhe përgjegjësitë*, marrë nga: <http://www.ammk-rks.net/?page=1,123>.
- \_\_\_\_\_, AMMK, Drejtorati për Monitorimin e Mjedisit, marrë nga: <http://www.ammk-rks.net/index.php?page=1,30>.
- \_\_\_\_\_, AMMK, *Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës*, marrë nga: <http://www.ammk-rks.net/?page=1,127>.
- \_\_\_\_\_, AMMK, *Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës*, at: <http://www.ammk-rks.net/?page=1,118>.
- \_\_\_\_\_, Ministria e Financave, Qarkorja Buxhetore 2016/02, marrë nga: <http://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/BEFC8D14-98A8-4F18-8CED-72A8DAEB178C.pdf>.
- \_\_\_\_\_, Ministria e Financave, Qarkorja Buxhetore 2017/01, marrë nga: <https://kk.rks-gov.net/kline/getattachment/26277141-8e00-4daa-90a6-9880a7f8a0f3/Qarkorja-Buxhetore-2017.aspx>.
- \_\_\_\_\_, Ministria e Punëve të Brendshme, *Raporti Statistikor K1 2016 DSHAM/MPB*, at: <http://mpb-ks.org/repository/docs/TMI - SHQIP 2016 web.pdf>.
- \_\_\_\_\_, Ministria e Punëve të Brendshme, *Raporti Statistikor K2 2016 DSHAM/MPB*, at: [http://mpb-ks.org/repository/docs/Rap\\_K2\\_2016 Alb web.pdf](http://mpb-ks.org/repository/docs/Rap_K2_2016 Alb web.pdf).
- \_\_\_\_\_, Ministria e Punëve të Brendshme, *Raporti Statistikor Vjetor, 2015, DSHAM/MPB*, marrë nga: [http://mpb-ks.org/repository/docs/WEB\\_Raport\\_2015\\_Shqip.pdf](http://mpb-ks.org/repository/docs/WEB_Raport_2015_Shqip.pdf).
- \_\_\_\_\_, MMPH, Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, marrë nga: <http://mmp-h-rks.org/sq/Agjencia-e-Kosoves-per-Mbrojtje-nga-Rrezatimi-dhe-Siguria-Berthamore---AMRK>.
- \_\_\_\_\_, MMPH, AKK, Lista e Gjeodetëve [Matësve] të Certifikuar, marrë nga: <http://www.kca-ks.org/documents/10179/25744/Licencat+per+Gjeodet+definitive.pdf/a2a47cbd-5aec-4f0f-bb8c-a39f5a0148c6>.
- \_\_\_\_\_, MMPH, AKK, marrë nga: <http://akk-statistics.rks-gov.net/>.
- \_\_\_\_\_, MMPH, AKK, Organogrami, marrë nga: <http://www.kca-ks.org/organogrami>.
- \_\_\_\_\_, MMPH, *Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit*, at: <http://mmp-h-rks.org/sq/Departamenti-i-Planifikimit-Hapesinor,Ndertimit-dhe-Banimit->
- \_\_\_\_\_, MMPH, *Departamenti i Prokurimit*, marrë nga: <http://mmp-h-rks.org/sq/Departamenti-i-Prokurimit>.
- \_\_\_\_\_, MMPH, *Njësia për të drejtat e njeriut*, at: <http://mmp-h-rks.org/sq/Nj%C3%ABsia-p%C3%ABr-t%C3%AB-Drejtat-e-Njeriut>.
- \_\_\_\_\_, MMPH, *Plani i Kosovës për veprim në mjedis*, Prishtinë: 2006, marrë nga: [http://ammk-rks.net/repository/docs/Plani\\_i\\_Kosoves\\_per\\_Veprim\\_ne\\_Mjedis.pdf](http://ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_Kosoves_per_Veprim_ne_Mjedis.pdf).
- \_\_\_\_\_, MMPH, *Plani i Veprimit për Zhvendosje: Projekti për lagjen Shala në fshatin Hade, Kosovë*, 2011, f. 18, marrë nga: [http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Plani\\_i\\_veprimit\\_per\\_zhvendosje-Lagjia\\_ShalaHade - ENG.pdf](http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Plani_i_veprimit_per_zhvendosje-Lagjia_ShalaHade - ENG.pdf).
- RrGGK, Arritja e ekuilibrit: *Opsionet e politikave që synojnë të informojmë amandamentimin e Ligjit të Punës në Kosovë*, Prishtinë: 2016, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20160504154201554.pdf>.
- \_\_\_\_\_, *Udhërrëfyes Praktik: Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor në Nivelin Qendror*, Prishtinë: 2014, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20141128100658900.pdf>.
- Sadhu, G. dhe Chakravarty, N., "Gender Mainstreaming in Water Management", *International Journal of Scientific and Research Publications* ["Integrimi gjinnor në menaxhimin e ujit," *Revista Ndërkombëtare e Publikimeve Shkencore dhe Kërkimore*], vëllimi 2, numri 11, nëntor 2012, marrë nga: <http://www.ijsrp.org/research-paper-1112/ijsrp-p1110.pdf>.
- UNDP, *Iniciativa për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë në Kosovë*, marrë nga: <http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/KDRR/2013.05.28%20KDRRI%20Prodoc%20SIG NED.pdf>.

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

336.12:504.3(496.51)(047)

Buxhetimi për një mjedis më të mirë : analizë gjinore e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinr / Nga Nicole Farnsworth... [et al.]. – Prishtinë : Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2016. – 52 f. : ilustr. ; 21 cm.

1.Farnsworth, Nicole

**ISBN-978-9951-737-00-5**



